



RESPUBLICA

# k o m e n t a r

i ligjit nr. 119/2014 "për të drejtën e informimit"  
së bashku me praktikën e Komisionerit për të Drejtëm e Informimit



National Endowment for Democracy  
*Supporting freedom around the world*



National Endowment for Democracy  
*Supporting freedom around the world*

*Ky publikim është përgatitur nga qendra "Res Publica" me mbështetjen e National Endowment for Democracy. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e qendrës Res Publica dhe nuk reflekton opinionin e National Endowment for Democracy.*

Botues: Qendra "Res Publica"  
Autor: Dorian Matija  
Tirazhi: 200 kopje  
Tiranë, maj 2015



**RESPUBLICA**

# k o m e n t a r

i ligjit nr. 119/2014 "për të drejtën e informimit"

---

së bashku me praktikën e Komisionerit për të Drejtëm e Informimit  
dhe Mbrojtjen e të Dhënavë Personale

---

material ndihmës për gazetarët dhe aktivistët e shoqërisë civile



# TREGUESI I LËNDËS

Hyrje.....	4
KREU I - OBJEKTI, QËLLIMI DHE PËRKUFIZIMET.....	6
1. Subjektet e detyruar për të dhënë informacion.....	8
2. Cfarë përfshihet në "Informacionin publik"?.....	13
3. Kush ka të drejtë të kërkojë informacionin/dokumentin?.....	16
4. Cfarë konsiderohen të dhëna personale?.....	17
5. Koordinatorët e informacionit.....	18
KREU II - E DREJTA E INFORMIMIT DHE TRANSPARENCA.....	20
1. E drejta e informimit.....	21
2. Programet e transparencës.....	22
3. Regjistrimi i kërkesave dhe përgjigjeve.....	27
4. Kompetencat e koordinatorit për të drejtën e informimit.....	28
KREU III - NJOHJA ME INFORMACIONIN PUBLIK.....	30
1. Mënyra e kërkimit të informacionit.....	31
2. Përbajtja e kërkesës për informim.....	33
3. Saktësimi dhe trajtimi i kërkesës për informim.....	34
4. Kostoja e shërbimit.....	35
5. Mënyrat e dhënies së informacionit.....	37
6. Afati për marrjen e informacionit.....	38
7. Njoftime paraprake për kërkuesin.....	40
KREU IV - KUFIZIMI I SË DREJTËS PËR INFORMIM.....	42
1. Kufizimet.....	43
2. Rishikimi i klasifikimit të dokumenteve "sekret shtetëror".....	48
3. Aksesi i pjesshëm në informacion.....	49
KREU V - SHKELJET DHE SANKSIONET ADMINISTRATIVE.....	52
1. Kundërvajtjet administrative.....	53
2. Përgjegjësia administrative.....	54
3. Marrëhëniet me Kuvendin.....	56
4. Sanksionet administrative.....	57
5. Ankimi i sanksioneve administrative.....	58
6. Arkëtimi i shumave të detyrimeve.....	58
KREU VI - PROCEDURAT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE.....	60
1. Procedurat për shqyrtimin e ankesave.....	61
2. Avokati i Popullit.....	63
3. Ankimi në gjykatë.....	64
4. Shpërblimi i demit.....	65
Konsiderata të fundit.....	66

# HYRJE

Pas një historie të gjatë e të pasuksesshme të përdormit të një ligji të miratuar që në vitin 1999 (nr. 8503), e drejta e informimit më në fund ka hyrë në erë të re me miratimin e ligjit nr. 119/2014. Ligji që lamë pas ishte shumë larg standardeve të kohës. Kishte mangësi që shkaktonin probleme në interpretimin e tij, afatet ishin të stërvizuar, mungonte një mënyrë efektive për të penalizuar syrtarët që refuzonin informacionin pa shkak, etj.

Megjithëse në këto dy dekada kemi përjetuar një revolucion të legjislacionit, liria e informimit e gjeti me vështirësi rrugën drejt efektivitetit. Qeveritë prej kohësh kanë pasur një mangësi në kuptimin plotësish të dallimit mes një qeverie të hapur dhe lirisë së informacionit. Qeveri e hapur do të thotë që ajo vendos të publikojë informacionin me nismën e vet. Këtu futet informacioni që qeveria mendon se ne kemi nevojë të dimë, ose që mund të dëshirojmë të dimë. Ndërsa liria e informimit kërkon që qeveria të japë informacion shpjegues, të cilin ne kemi vendosur vetë që duam ta dimë. Të dyja këto mund të mos përkijnë sepse shumë kërkesa për informacion bëhen për interesat private dhe jo në emër të interesit publik. Liria e informimit është rastësore dhe shpesh e vështirë për t'u parashikuar. Ligji i ri, ndonëse duket fillimisht si i bazuar në modelin paternalist të qeverisë së hapur, me në qendër qeverinë që vendos se çfarë duhet të dime, ka përfshirë gjëresisht edhe lirinë e informimit. Duke zgjeruar hapësirën e lirisë së informimit skemat proaktive të botimit nuk krijojnë varësi, por vijnë në ndihmë. Evaziviteti i përkufizimeve është shumë më pak i ndjeshëm, ndonëse në praktikë mund të ketë probleme për të kuptuar qartë të drejtën për të kërkuar *prodhimin* e një informacioni enkas për kërkuesin, apo për të njohur *arsyetimin* e një vendimmarrjeje administrative, si dhe për të ushtruar kontrollin mbi zbulimin e diskutimeve/këshillave që ndikojnë në vendimmarrjen e drejtuesve të lartë. Me anën e krijimit të një organi të ri vendimmarrës (Komisioneri për të Drejtën e Informimit) po bëhet e

mundur që ligji të pasurohet me praktika të unifikuara që plotësojnë boshllëqet, sidomos përmes provokimit të rasteve nga OJF të specializuara në *litigimin strategjik*, siç është Res Publica.

Me një hap mjaft cilësor përpara, ligji i ri parashikon një sërë rregullash favorizuese, që në ndryshim nga ligji i mëparshëm, i jepin mundësinë e kthimit të tij në një ligj praktik dhe të vlefshëm. Kështu mund të përmendim afatet e shkurtra, ekzistencën e një organi që shqyrton ankesat, sanksionet për zyrtarët që refuzojnë dhënien e informacionit, mundësinë e konsultimit të dokumentit në vend, rishikimi i klasifikimit të dokumentave sekret, etj.

Më tej, në këtë komentar, përpinqemi që ta lehtësojmë përdorimin e këtij ligji, nëpërmjet sqarimit të disa detajeve që ato të kuptohen më mirë edhe nga individë të cilët nuk kanë formim juridik. Ky komentar është pasuruar edhe me praktikat më të fundit të Komisionerti për të Drejtën e Informimit.

Qëllimi kryesor i këtij komentari është që gazetarët dhe aktivistët e shoqërisë civile në përgjithësi dhe gazetarët investigativë në veçanti, të orientohen drejt përdorimit të suksesshëm të ligjit, duke e hedhur dritë mbi skutat e qeverisjes. Në fund të fundit, qeveria punon më mirë kur është transparente.

OBJEKTI,  
QËLLIMI DHE  
PËRKUFIZIMET

KREU I

**L**igji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” synon të rregullojë të drejtën e njohjes me informacionin që *prodhohet ose mbahet* nga autoritetet publike. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive kushtetuese të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë (*neni 1*). Kjo do të thotë që ligji nuk është vetëm një mjet i mirë në dorë të gazetarëve, apo të aktivistëve të shoqërisë civile, por në dorë të publikut të gjerë në përgjithësi.

Ligji ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti tjetër joshtetëror që ushtron funksione publike.

Liria e informimit është pjesë përbërëse e lirisë së fjalës, e cila është e drejtë themelore e njeriut, e njohur në të drejtën ndërkontaktare, e cila është sot përkufizohet si “*liria e shprehjes*”, në çdo formë, me gojë, me shkrim, në median e shtypur, përmes internetit apo përmes formave të ndryshme të arteve pamore. Kjo do të thotë se mbrojtja e lirisë së fjalës si një e drejtë përfshin jo vetëm përmbytjen, por edhe mjetet dhe mënyrat e shprehjes. Liria e shprehjes nuk kuptohet pa lirinë e informimit, pasi shprehja dhe informimi janë dy anët e një komunikimi publik.

Aktualisht janë mbi 70 vende që e kanë njohur lirinë e informimit për veprimtarinë e organeve qeveritare. Në rreth 20 prej këtyre vendeve (përfshirë këtu edhe Shqipërinë) liria e informimit gjithashtu zbatohet për organizmat privatë në rrethana të caktuara.

Aksesi në informacion është njohur gjithnjë si një parakusht për transparencë dhe llogaridhënie të qeverive përpara votuesit dhe taksapaguesit, si aftësi e konsumatorëve për të bërë zgjedhje të informuara, si dhe për t’iu mundësuar qytetarëve të kundërshtojnë keqmenaxhimin dhe korrupcionin. Kjo ka bërë që një numër në rritje të vendeve të miratojnë ligje për të drejtën e informimit në dy dekadat e fundit. Në vitet e fundit, organizmat privatë kanë filluar të përfshihen në kryerjen e funksioneve të cilat janë kryer më parë nga organet publike. Privatizimi dhe dhënia me koncension ka përfshirë në sferën publike edhe banka, kompani telekomunikacioni, spitale dhe universitete, të cilat janë

subjekte tërësisht privatë. Duke përfshirë edhe këto subjekte, është zgjeruar liria e informimit edhe për veprimtaritë publike që mbulohen prej tyre.

## 1. Subjektet e detyruar për të dhënë informacion (neni 2, pika 1)

Cilët përfshihen konkretisht tek subjektet e detyruar për të dhënë informacion? Përgjigjen e jep nenii 2 i ligjit, i cili përfshin tre kategoritë kryesore të autoriteteve publike:

**Kategoria e parë** përfshin çdo organ administrativ të parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike të krijuara me Kushtetutë ose me ligj. Le t'i trajtojmë me rradhë:

- Organet administrative janë ata që parashikohen nga Kodi i Procedurave Administrative, të cilët janë: organet e pushtetit qendror që kryejnë funksione administrative, organet enteve publike në masën që ato kryejnë funksione administrative, organet e pushtetit vendor që kryejnë funksione administrative, organet e Forcave të Armatosura, si dhe çdo strukturë tjeter, punonjësit e së cilës gjëzojnë statusin e ushtarakut, për aq kohë sa këto kryejnë funksione administrative.

Kështu, me fjalë më të thjeshta, përfshihen:

- Kryeministria, ministritë, drejtoritë në varësinë e tyre, komisionet e ndryshëm, këshillat dhe bordet që varen nga Këshilli i Ministrave apo nga ministri të ndryshme, etj.
- Ajencitë shtetërore, institucionet e pavarura kushtetuese si Kontrolli i Lartë i Shtetit, Avokati i Popullit, etj, entet, institutet, fondet e krijuara me ligj, universitetet dhe akademitë publike, media publike, federatat, etj.
- Bashkitë, komunat, qarqet, prefekturat, etj.
- Strukturat e forcave të armatosura, si Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë, Garda e Republikës, akademitë ushtarake dhe policore, etj.

Sic vihet re, në rastin e organeve të enteve publike apo forcave të armatosura, ka një kufizim, që informacioni mund të kërkonhet vetëm për ato veprime që janë të një natyre administrative. Për shembull, Radiotelevizioni Publik është një ent i cili siguron transmetime televizive në interes të publikut dhe në një mënyrë ai konkuron me mediat private. Disa informacione që cenojnë interesat tregtarë të medias publike nuk mund të aksesohen. Këtu mund të përfshihen disa teknologji të caktuara transmetimi, apo disa kanale tregtare për sigurimin e të drejtave të autorit përmes agjentëve të specializuar të huaj, etj, të cilat mund të mbrohen nga sekreti tregtar, për sa kohë kjo mbrojtje bëhet me qëllim ruajtjen e një avantazhi tregtar të siguruar përmes një investimi të madh monetar dhe të gjatë kohor. Sigurisht që në këto kontrata mund të jepen informacione për kontraktuesin, apo për pajisjen e blerë, por jo për veçoritë specifike të këtyre pajisjeve, manualeve të trajnimit, mënyrës së lidhjes së këtyre pajisjeve, etj. Por, nga ana tjetër media publike kryen funksione administrative në lidhje me procedurat e prokurimit, lidhjen e kontratave të punësimit, dhënien e qirave, etj, të cilat janë informacione që mund të aksesohen<sup>1</sup>.

Sigurisht që nuk është e lehtë të vizatosh një vijë të qartë ndarëse se ku mbaron veprimitaria administrative dhe ku zë fill *sekreti tregtar*. Këtë vijë e përcakton rast pas rasti organi që është i përcaktuar nga ligji si rojtari i të drejtës së informimit, i cili është *Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjtjen e të Dhënave Personale*. Është detyrë e këtij organi që të ushtrojë atë që quhet “*balanca e proporcionalitetit*” midis dy të drejtave që përplasen me njëra tjetrën, lirisë së informimit nga njëra anë, dhe të drejtës për të mbrojtur të dhëna private apo sekrete të mbrojtura nga ana tjetër<sup>2</sup>. Themi ras pas rasti sepse asnjëherë nuk mund të përcaktohet një formulë fikse. Në disa raste interesi publik mund të jetë shumë i madh dhe informacionet private nuk duhet të mbrohen, kurse në disa raste të tjerë interesi publik mund të jetë i papërfillshëm. Çelësi i zgjidhjes është gjithnjë në varësi të vlerësimit të pyetjes në kuadër të një interesi publik. Gazetarët dhe aktivistët e shoqërisë civile gëzojnë një mbrotjtje më të madhe në kërkesat e tyre

1 Komisioneri për të Drejtën e Informimit në Vendimin nr. 13, datë 03.02.2015 ka pranuar që RTSH (Radiotelevizioni Shqiptar) është autoritet publik në kuptimin e këtij ligji.

2 Me Vendimin nr. 6, datë 21.01.2015, Komisioneri për të Drejtën e Informimit ka vendosur që kontratat e lidhura nga OSHEE me furnitorët e tij, nuk mbrohen nga sekreti tregtar dhe si të tilla duhet ti jepen kërkuesit.

për informacion sepse ata nuk i kërkojnë informacionet vetëm për interesat e tyre private, por për t'ia bërë të njohura publikut në raste kur ka dyshime për akte korruptive apo keqadministrimi që dëmtojnë interesin e të gjithë shoqërisë.

- b. Tek organet ligjvénëse përfshihet Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me të gjitha strukturat e tij të brendshme, siç janë komisionet parlamentare, qofshin të përhershëm apo të përkohshëm. Por, në rrethana të veçanta, organ ligjvénës bëhet edhe Këshilli i Ministrave, i cili në bazë të nenit 101 të Kushtetutës ka të drejtë të miratojë akte normative me fuqinë e ligjit, të cilat duhet më pas të konvalidohen brenda 45 ditësh nga Kuvendi.
- c. Tek organet gjyqësore përfshihen të gjitha gjykatat e çdo niveli, siç janë gjykatat civile, penale apo administrative të shkallës së parë, të apelit, apo Gjykata e Lartë. Këtu përfshihet edhe Gjykata Kushtetuese. Përveç sistemit normal të gjykatave, në këtë kategori bëjnë pjesë edhe gjykatat e arbitrazhit. Në një *interpretim* të zgjeruar, brenda kësaj kategorie duhet të futen edhe autoritetet që kryejnë shërbimin e zgjidhjeve të konflikteve me pajtim, si dhe përmbaruesit gjyqësorë.
- d. Organet e prokurorisë janë përmendur në mënyrë të veçantë në ligj për të paktën dy arsyet kryesore: (1) sepse deri përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji të ri prokuroria nuk është përfshirë shprehimisht tek organet që detyrohen të bëjnë publikë informacionet që disponojnë, duke krijuar konfuzion të zbatimit të ligjit në praktikë. Informacionet kanë qenë të aksueshëm vetëm nga palë të interesuara për procedime të caktuara dhe vetëm në bazë të Kodit të Procedurës Penale, i cili rezervon disa dispozita të veçanta përmarrjen e kopjeve të dokumentave; (2) sepse prokuroria, ndonëse bën pjesë në zinxhirin e drejtësisë, nuk është një organ që teorikisht bën pjesë në pushtetin gjyqësor. Prokuroria ushton më shumë një pushtet të natyrës ekzekutive se sa gjyqësore. Në Shqipëri organet e prokurorisë janë të pavarura nga pushteti ekzekutiv, por në botë ekzistojnë edhe modele që e paraqesin prokurorinë si një organ të mirëfilltë të pushtetit ekzekutiv.

**Kategoria e dytë** përfshin shoqëritë tregtare ku shteti zotëron shumicën e aksioneve; ose të cilat ushtrojnë funksione publike, të dhëna me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjeter, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Më konkretisht, në këtë kategori përfshihen të gjitha shoqëritë tregtare që vazhdojnë të janë me kapital 100 % shtetëror, ose ato ndërmarrje/shoqëri të cilat janë privatizuar pjesërisht dhe ku shteti ka mbi 50% të aksioneve, si për shembull ndërmarrja MEICO (100% të aksioneve), Albpetrol (100% të aksioneve), etj.

Në këtë kategori përfshihen edhe ato shoqëri tregtare tërësisht private apo ato ku shteti ka 50% të aksioneve ose edhe më pak (si për shembull Federata Shqiptare e Futbollit<sup>3</sup>), të cilat ushtrojnë funksione publike.

Por çfarë kuptohet me kryerje të funksionit publik nga një shoqëri tregtare private? Çdo shoqëri tregtare ka një objekt të veprimtarisë, si për shembull shitja me shumicë dhe pakicë të veshjeve dhe këpucëve. Por në disa raste të tjera shoqëritë ushtrojnë edhe funksione që janë përcaktuar nga ligji si funksione publike, të cilat në originë janë detyrime të shtetit. Shembull është kontrolli teknik i automjeteve. Sipas Kodit Rrugor kontrolli teknik i automjeteve bëhet në përgjegjësinë e ministrisë që mbulon transportet. Por kjo ministri mund të mos e realizojë vetë këtë proces dhe vendos të kontraktojë një subjekt privat që të kryejë kontrollin teknik përkundrejt një tarife, duke marrë përsipër të gjithë investimin e nevojshëm. Dokumenti i lëshuar nga kjo kompani ka vlerë ligjore për automjetet dhe njihet nga organet e policisë së shtetit. Në këtë rast veprimtaria është me natyrë publike pavarësisht se shoqëria tregtare është me kapitale 100% private. Shoqëri tregtare të tjera mund të janë edhe universitetet, apo spitalet që mbështeten nga skema e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor, etj. Me interes të veçantë janë kërkuesat që vijnë nga grupe dhe OJF mjedisore, të cilët u kërkojnë informacion shoqërive private pér dëmin e mundshëm të mjedisit të shkaktuar nga projektet e tyre të investimeve.

3 Një shembull i trajtuar nga Komisioneri pér të Drejtën e Informimit është edhe Federata Shqiptare e Futbollit. Me vendimin nr. 16 datë 03.02.2015, Komisioneri vendosi ta përfshijë edhe FSHF në kategorinë e “autoriteteve publike”, pasi kërkoi edhe mendimin e ministrisë së linjës. Vetëm 30% e aksioneve të FSHF janë në pronësi të shtetit, por Komisioneri e cilësoi objektin e veprimtarisë së saj si “veprimtari publike”. Në një shembull tjetër, në Vendimin nr. 28, datë 15.04.2015, Komisioneri pér të Drejtën e Informimit është shprehur se Klubi i Futbollit Tirana nuk është autoritet publik sepse Bashkia Tiranë ka vetëm 34% të aksioneve dhe Komisioneri nuk është i mendimit se ky subjekt nuk ushton veprimtari publike.

**Kategoria e tretë** e autoriteteve publike përfshin edhe çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjeter, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike. Sic shihet, legjislatori ka vendosur që të theksojë si kategori më vete ata persona fizikë dhe juridikë që ushtrojnë funksione publike të veçanta, si për shembull në fushën e arsimit, shëndetësisë, telekomunikacionit, energjisë etj, pavarësisht se mund të mos jenë financuar aspak nga fonde të buxhetit të shtetit. Kjo risi në ligj ka të bëjë me konceptimin se shoqëritë tregtare që operojnë në fusha të tillë kanë një impakt të drejtpërdrejtë dhe të rëndësishëm në jetën publike. Një kompani që tregon piye freskuese nuk ka një impakt të ndjeshëm në jetën publike, por kompania që furnizon popullatën me energji elektrike (edhe sikur kjo kompani të mos ishte në pronësi të shtetit) ka një rol kyç në ekonominë e vendit dhe cilësinë e jetës së konsumatorëve. Është pikërisht nevoja për mbrojtjen e konsumatorëve një nga faktorët kryesorë që ka diktuar përcaktimin e një rregulli të tillë, që të përfshijë brenda subjekteve të detyruara për të dhënë informacion edhe këto subjekte tërësisht private. Të gjithë këto subjekte operojnë në treg me anën e licensave speciale, të cilat mund edhe të revokohen nëse konsumatorët referojnë raste të mospërmbushjes së detyrimeve lidhur me cilësinë e produktive ose shërbimeve. Këto shoqëri tregtare zakonisht kanë pozitë dominante në treg, gjë që i jep atyre një pushtet të madh jo vetëm ekonomik.

Për të kuptuar pak më shumë rreth këtij koncepti, kujtojmë që në vitin 1983 Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Korporatat Ndërkufitare ka miratuar Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e Konsumatorëve ku përcaktohet se te të drejtat e konsumatorit duhet përfshirë edhe “*qasja e konsumatorëve në informacione të mjaftueshme për të mundësuar bërjen e zgjedhjeve të informuara sipas dëshirave dhe nevojave individuale*”. Qasja në informacion konsiderohet si e drejtë themelore e konsumatorit, dhe zbulimi parandalues, dmth zbulimi i informacionit mbi kërcënimet për jetën e njeriut, shëndetin dhe sigurinë, është theksuar me një rëndësi prioritare.

Megjithatë, duhet thënë se edhe në këtë rast, nuk duhet kuptuar që kjo kategori subjektesh është e detyruar të japë çdo informacion të kërkuar. Ligji e kufizon këtë detyrim vetëm për informacionet që lidhen me funksionet publike, ose me interesin publik, ku përfshihet edhe interes i investitorëve apo konsumatorëve. Me fjalë më të thjeshta, për shembull, kompania që siguron shpërndarjen e

energjisë kryen funksion publik në rastin e atyre shërbimeve që Enti Rregulator i Energjisë ka përcaktuar cilësinë me anën e një rregulloreje të posaçme.

Abonentët kanë të drejtë të kërkojnë informacion për ndërprerjet e energjisë elektrike apo për cilësinë e energjisë së servirur në momente të caktuara.

Por nuk mund të bëhet publik informacioni që ka të bëjë për shembull me strategjitet e marketingut të kompanisë dhe anketimet që kompania i mbledh për interesat e studimit të tregut.

Meqënëse në kuptimin e “autoritetit publik” përfshihen edhe subjekte joshtetërore, mbetet e paqartë nëse edhe këto subjekte duhet të miratojnë një program transparency, të publikojnë një regjistër të kërkesave dhe përgjigjeve, dhe çdo detyrim tjetër që përcaktohet nga ligji, pasi në praktikë kjo do të rezultojë tejet e vështirë dhe nuk do të kuptohet në këtë mënyrë prej tyre. Megjithatë, në të gjitha rastet, Komisioneri për të Drejtën e Informimit nuk ka ngurruar të përsërisë të njëjtën kërkesë për të gjithë subjektet e klasifikuar si “autoritete publike”, të cilët duhet të emërojnë një “koordinator për të drejtën e informimit” si dhe duhet të publikojnë “programin e transparencës”. Në këtë mënyrë, Komisioneri nuk ka bërë asnjë dallim, duke qartësuar qendrimin.

## 2. Cfarë përfshihet në “Informacionin publik”? (neni 2, pika 2)

Sipas nenit 2 të ligjit, “*Informacioni publik*” përfshin çdo të dhënë të regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik. Kjo nënkupton se autoritetet janë të detyruara të japid akses në dokumentet që disponojnë në arkivat apo dosjet e tyre të punës, qofshin këto dokumente shkresorë ose audiovizualë, apo çdo lloj tjetër. Dokumentet mund të ndahen në tre kategorit:

- Dokumente të krijuara nga vetë autoriteti
- Dokumente të ardhura prej një autoriteti tjetër
- Dokumente të ardhura prej subjekteve privatë

Në kategorinë e parë përfshihen të gjitha dokumentat që krijohen nga vetë autoriteti, sic janë vendimet, rregulloret, udhëzimet, urdhërat, kontratat, memot, shkresat përcjellëse, dhe çdo dokument tjetër që i shërben komunikimit normal midis njësive të brendshme të strukturës së autoritetit publik.

**Në kategorinë e dytë** përfshihen dokumentet që kanë ardhur nga një autoritet tjeter publik, sic janë informacionet, urdhërat, raportet, vendimet dhe çdo dokument tjeter që i shërben komunikimit midis dy autoriteteve të ndryshme, pavarësisht raportit të hierarkisë midis tyre.

Shpesh herë një dokument ndodhet në më shumë se një autoritet. Për shembull një vendim i Këshillit Kombëtar të Territorit për rikonstrukcionin e një stadiumi mund të gjendet pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit (në varësinë e të cilës është KKT), por mund të gjendet edhe pranë: (1) Ministrisë së Arstimit dhe Sportit sepse ky autoritet merr pjesë në menaxhimin e projekteve zhvillimore të infrastrukturës sportive, (2) Federatës Shqiptare të Futbollit, si enti i interesuar për implementimin e projektit (3) Bashkisë përkatëse ku ndodhet stadiumi, si enti që duhet të implementojë projektin (4) Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik Vendor të bashkisë përkatëse, si enti që duhet të kujdeset për zbatimin e prishjes së ndërtimeve që preken nga implementimi i projektit. Përvec vetë KKT, edhe autoritetet e tjera që e kanë marrë një kopje të vendimit janë të detyruar që të japid akses në kopjen e tyre, pavarësisht se ku ndodhet kopja e origjinës dhe pavarësisht se kërkuesi mund të ketë pasur akses në të njëjtin dokument nga autoriteti tjeter. Në praktikë mund të ndodhë që vendimi, së bashku me skicat bashkangjitur mund të ketë pësuar ndryshime të parregullta gjatë komunikimit nga një autoritet te tjetri dhe është shumë e rëndësishme që të aksesohet çdo version i dokumentit. Në këtë mënyrë, për shembull, mund të identifikohet një ndryshim i parregullt, i cili është i dënueshëm sipas legjisacionit penal dhe aksesi në të gjithë versionet e dokumentit pranë çdo autoriteti që disponon një të tillë, është i një rëndësie thelbësore për të evidentuar shkeljen e ligjit dhe vënë përpala përgjegjësisë personin përgjegjës.

**Në kategorinë e tretë** përfshihen dokumentat që janë prodhuar dhe dorëzuar nga persona privatë. Këto dokumenta mund të janë të produhuara prej një autoriteti publik (p.sh. certifikata, vërtetime) ose mund të janë të produhuara nga vetë personi privat (p.sh. ofertë, deklaratë, etj). Zakonisht këto dokumenta janë pjesë përbërëse e dosjeve të vendimmarrjes së autoriteteve publike. Për shembull, dosjet e prokurimeve publike janë të mbushura me shumë dokumente të produhuara apo të dorëzuara nga subjekte privatë konkurues, ose dosjet për aplikimin për një licensë, apo marrjen e një koncensioni, etj.

Në praktikë deri më sot nuk ka pasur probleme lidhur me aksesin në kategorinë e parë të dokumenteve. Por problemet janë shënuar për kategorinë e dytë dhe të tretë. Shpesh autoritetet janë përgjigjur se informacioni ose dokumenti duhej kërkuar gjetkë, tek origjina e tij, ndonëse ai autoritet e dispononte dokumentin. Aksesi në dokumentet privatë që disponohen nga autoritetet shtetërore ka qenë problematik gjithashtu. Disa autoritete e kanë konceptuar gabim faktin që dokumenti ka qenë privat dhe nuk është prodhuar nga autoriteti publik, duke mos e konsideruar si dokument të aksesueshëm. Një shembull tipik i gabuar është vendimi nr. 12/2004 i Komisionit të Prokurimit Publik i cili u shpreh se:

*“III.4. Nga interpretimi logjik dhe literal gramatikor i nenit 12, KPP gjykon se me “informacioni i administruar” (shprehje e përdorur në nenin 21) do të kuptohen procesverbale dhe dokumentacione të mbajtura dhe hartuara nga vetë autoriteti kontraktor dhe jo dokumentacioni apo oferta e dorëzuar nga ana e operatorëve ekonomikë, pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.”*

Në këtë vendim Komisioni i Prokurimit Publik ka konsideruar në mënyrë të gabuar se vetëm dokumentet e produhuara nga autoritetet shtetërore mund t'i jepen të interesuarit dhe jo dokumentat e dorëzuar nga ana e operatorëve privatë. Ligji i ri hedh dritë mbi këtë pikë të dyshimtë, duke u shprehur se aksesi është i mundur në të gjitha dokumentet që nga autoriteti, *“pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”*. Kjo është një zgjidhje e drejtë që jep ligji, pasi vetëm përmes kontrollit të dokumenteve, qofshin këto të produhuara nga vetë aurotiteti, ose të ardhura prej një autoriteti tjeter apo prej një subjekti privat, mund të arrihet në konkluzionin nëse vendimmarrja ka qenë e drejtë dhe në përputhje me ligjin. Publiku ka të drejtë të njihet me dokumentet jo vetëm përtu informuar, por edhe përtë ushtruar të drejtën e kërkimit të llogarisë.

Sigurisht që, sidomos lidhur me dokumentet privatë, aksesi mund të kufizohet nga mbrojtja e të dhënavë personale apo tregtarë. Megjithatë kjo mbrojtje nuk mund të shtrihet:

- Në të gjithë dokumentat që ndodhe në dosje (të cilët nuk përbajnë informacion rreth ndonjë sekreti tregtar);
- Nëse subjekti i të drejtës ka dhënë pëlqimin për publikimin e informacionit (ose pëlqimi për konfidencialitetin nuk e ka përsfirë dokumentin e kërkuar);

- Në të gjithë përbajtjen e një dokumenti specifik (në ato pjesë që nuk ka shkak për të mbrojtur informacionin).

Në këto kushte, dokumentet mund të aksesohen pjesërisht dhe në përputhje me pëlqimin e dhënë nga subjekti i të drejtës për mbrojtjen e të dhënavë personale apo tregtare.

Dokumentet që nuk ekzistojnë<sup>4</sup>, ose dokumentet që nuk janë krijuar ende nuk janë të kërkueshëm. Këtu mund të përfshihen analiza të ndryshme që autoritetit i duhet punë ta përpilojë. E drejta për informim nuk presupozon krijimin e një dokumenti të ri enkas për kërkuesin.<sup>5</sup>

### **3. Kush ka të drejtë të kërkojë informacionin/dokumentin? (neni 2, pika 3)**

Neni 2 ligjit ka përcaktuar se kërkues mund të jetë çdo person, fizik apo juridik, vendas apo i huaj, apo edhe pa shtetësi. Në këtë mënyrë nuk ka rëndësi nëse kërkuesi është individ, person juridik tregtar, person juridik joftimprurës, vendas apo edhe shtetas i huaj, apo fare pa shtetësi, për të kërkuar aksesin në dokumenta. Gjithashtu nuk paraqet pengesë as fakti nëse shtetasi i huaj jeton ose jo në Republikën e Shqipërisë, dhe nëse ka ose jo leje qendrimi në Republikën e Shqipërisë.

---

4 Në Vendimin nr. 21, datë 04.03.2015, Komisioneri për të Drejtën e Informimit shprehet: “Komisioneri vlerëson se kërkesat për tu pajisur me shkresën e zyrës së financës për ndërprerjen e pagesës, shkresën drejtuar Sigurimeve shoqërore për ndërprerjen e pagesës, shkresën për miratimin e tërheqjes së librezës së punës si dhe pajisja me kërkesën për korrigimin e librezës së punës nuk janë objekt i ligjit për të drejtën e informimit për aq kohë sa një informacion i tillë nuk ekziston. Ky ligj parashikon qartë në nenin 1 të tij të drejtën e infomimit lidhur me dokumentacionin që mbahet dhe prodhohet nga Autoriteti Publik dhe nuk detyron këtë të fundit të prodrojë një informacion të ri kundrejt një kërkese.”

5 Në Vendimin nr. 17, datë 13.02.2015, Komisioneri për të Drejtën e Informimit shprehet: “Sa i përket kërkesës për pajisje me dokumentacionin që i përket “të ardhurave mujore të xxxx, çmohet se informacioni i kërkuar duhet të krijohet dhe si i tillë ai nuk i nënshtrohet zbatimit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ky parashikim merr rëndësi të veçantë në rastet e aksesit në informacion të emigrantëve që jetojnë jashtë Republikës së Shqipërisë dhe që mund të kenë lënë edhe shtetësinë shqiptare, si dhe në rastet e investitorëve të huaj.

#### **4. Cfarë konsiderohen të dhëna personale? (neni 2, pika 4)**

Ligji i ri nuk jep një përkufizim për të dhënat personale, por bën një referencë tek ligji përmbrojtjen e të dhënavë personale. Ligji nr. 9887 dt. 10.03.2008 “Përbrojtjen e të dhënavë personale” përcakton se:

“*Të dhëna personale*” është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social”

Në një pamje të parë vihet re se të dhënat personale lidhen ngushtë me qenien *person fizik*. Personat juridikë nuk janë të përfshirë në përkufizimin e mësipërm dhe të dhënat e tyre nuk janë të dhëna personale. Informacionet sensitive të personave juridikë tregtarë mund të përbëjnë sekret tregtar, por jo të dhëna personale.

Të dhënat personale janë informacione lidhur me numrat e identifikimit në regjistra të ndryshëm dhe që kanë lidhje me identitetin fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor ose social. Me fjalë të tjera, të dhënat rreth situatës shëndetësore dhe sëmundjeve të veçanta, të dhënat për të meta fizike, apo për të meta në funksione të caktuara fiziologjike të organizmit, janë të mbrojtura dhe të paaksueshme nga publiku. Gjithashtu edhe të dhëna të tjera rreth situatës ekonomike, apo rreth përkatësisë kulturore e sociale, të tilla që rrezikojnë sjelljen e stigmatizimit të individit në një shoqëri me intolerancë të ndjeshme, janë të mbrojtura dhe të paaksueshme nga publiku.

Mbrojtja e të dhënavë personale është e drejtë për sa kohë mungon interesit publik për të publikuar këto të dhëna. Publikimi mund të sjellë më shumë dëm individit se përfitim shoqërisë. Megjithatë, në rrethana të caktuara, kur interesit publik është më i lartë se interesit i individit, atëherë mbrojtja e të dhënavë

personale nuk mund të shërbejë si pengesë për aksesin në informacion. Për shembull, nëse kërkohet informacion mbi shëndetin mendor të një ministri, dëmi që mund t’i vijë këtij të fundit është shumë i parëndësishëm, në krahasim me përfitimin e shoqërisë nga publikimi i një informacioni që dëshmon se ai individ është i cenuar nga një sëmundje mendore që rezikon seriozisht vendimmarjen publike të këtij posti kaq të rëndësishëm. Në këtë rast duhet bërë dallimi mes aksesit në informacion dhe kontrollit të dokumenteve mjekësore. Në rast se kërkuesi nuk ka informacion dhe thjesht kërkon të konsultohet me kartelat mjekësore atëherë mund të jetë rasti që ky akses t’i refuzohet. Ndërsa nëse ka indicje paraprake dhe kërkohet një dokument specifik, i cili realisht përmban informacionin që dyshohet, atëherë aksesi në këtë dokument mund të pranohet.

## 5. Koordinatorët e informacionit (*neni 2, pika 6*)

Ligji ka përcaktuar për herë të parë emërimin e “*koordinatorëve për të drejtën e informimit*” pranë çdo autoriteti. Ata do të janë përgjegjës për dhënien e informacionit, dhe do të përballen me sanksione administrative nëse informacioni do të refuzohet në kundërshtim me ligjin dhe në tejlakim të afateve të përcaktuara në ligj.

Deri në hyrjen në fuqi të këtij ligjit të ri, pranë autoriteteteve nuk ka qenë e përcaktuar asnjë emërtësë që të përgjigjej për përbushjen e detyrimit për dhënien e informacionit/dokumenteve. Kjo ka sjellë një mungesë të theksuar përgjegjësie, ku autoritetet nuk përgjigjeshin brenda afateve dhe askush nuk mbante përgjegjësi për një sjellje të tillë të kundraligjshme. Gjithashtu mungesa e koordinatorëve ka sjellë vështirësi në praktikë edhe në ato autoritetet të cilët kanë pasur vullnetin e mirë që të japid informacionet. Mungesa e një personi përgjegjës ka bërë që shpesh kjo detyrë të mbetet pa një kujdestar të posaçëm, duke u lënë pas dore. Tashmë ky problem është zgjidhur teorikisht dhe mbetet të shihet në praktikë se si do të funksionojë zbatimi i sanksioneve ndaj personave përgjegjës.



E DREJTA E  
INFORMIMIT DHE  
TRANSPARENCA

KREU II

## 1. E drejta e informimit (*neni 3*)

**Koncepti i parë** i trajtuar nga nenı 3 i ligjit ka të bëjë me një element shumë të rëndësishëm, që personi që kërkon një informacion *nuk detyrohet të shpjegojë motivet*. Ky përcaktim ka qenë i pranishëm edhe në ligjin e shfuqizuar tashmë dhe nuk përbën risi. Megjithatë në praktikë shpesh organet e administratës vijojnë të bëjnë pyetjen: “*pse e kërkon dokumentin?*”. Madje këtë pyetje nuk kanë ngurruar ta bëjnë as gjyqtarët, të cilët janë njohës të mirë të ligjit.

**Koncepti i dytë** me rëndësi eshtë që autoriteti publik eshtë i detyruar të informojë kërkuesin *nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar*. Ky eshtë një element i ri në ligj, por në praktikë ka funksionuar pothuaj në të gjitha rastet që autoritetet publike janë shprehur kur nuk e kanë disponuar informacionin. Ndryshimi vjen në disa aspekte: (1) përgjigja e autoritetit nuk ka qenë e detyrueshme për t'u dhënë brenda një afati kohor të caktuar dhe ka ndodhur që kjo përgjigje eshtë dhënë vetëm kur çështja eshtë shtruar për zgjidhje përpara gjykatës; (2) përgjigja e autoriteteve bëhej në forma të papërshtatshme, si për shembull përmes bisedës telefonike ose nëpërmjet postës elektronike; (3) nuk shoqërohej me asnjë sanksion nëse autoriteti nuk deklaronte të vërtetën. Përfshirja e këtij detyrimi në ligj do të bëjë të mundur një përgjigje të shpejtë, në mënyrë të përshtatshme dhe nën përgjegjësinë e plotë të koordinatorit për informacionin pranë autoritetit përkatës.

**Koncepti i tretë** përfshin të drejtën për t'u njohur me dokumentin original ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit. Ligji i mëparshëm u jepte të drejtë kërkuesve që të merrnin kopje të dokumentit, por jo për të *inspektuar* dokumentin original. E vëtmja dispozitë që siguronte një të drejtë të tillë ishte nenı 52 i Kodit të Procedurave Administrative, por ky nen u jep të drejtë vetëm personave të interesuar, që janë palë në një procedim administrativ dhe jo personave të tjera. Ligji i ri siguron që kërkuesi mund të inspektojë dokumentin original në vendin që ai ruhet dhe më pas mund të kérkojë edhe kopje të dokumentit nëse e sheh të arsyeshme. Kjo dispozitë përbën një mjet të volitshëm në duart e gazetarëve që nuk duan të humbin kohë duke pritur një përgjigje. Ata mund të shkojnë në zyrat e autoritetit dhe të shfletojnë dosjen në vend duke kursyer kohë të vlefshme. Kjo e drejtë nuk përjashton mundësinë për të kërkuar menjëherë

marrjen e kopjes së dokumentit pa e inspektuar origjinalin. Dokumenti që jepet ne formen e kopjes mund të kerkohet që të jetë *i njësuar me origjinalin*, me qëllim përdorimin e tij në procedura të caktuara administrative apo gjyqësore.

**Koncepti i katërt** lidhet me detyrimin që informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë<sup>6</sup>. Edhe kjo është risi e ligjit. Nëse një dokument është dhënë një herë, atëherë nënkuftohet që është vlerësuar se nuk ekziston asnjë pengesë për ta bërë publik atë. Nëse ky dokument kerkohet përsëri nga një person tjetër, atëherë nuk ka asnjë arsyе përsë vendimmarra për ta bërë publik ose jo, të kalojë përmes së njëjtës analizë. I vetmi përjashtim është kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, situatë që mund të ndryshojë në varësi të pëlqimit të titullarit të të dhënave personale.

## 2. Programet e transparencës (nenet 4, 5, 6, 7)

*Programet e transparencës* përfshijnë tërësinë e informacionit dhe mënyrat e bërjes publike të tij nga ana e autoritetit publik. Programet e transparencës përfshijnë kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kérkesë nga publiku. Në përpjekje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësish të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet informacionet e parashikuara në nenin 7 të ligjit. Programi i transparençës synon të bëjë publik pjesën dërrmuese te informacioneve që zakonisht kerkohen të aksesohen. Kjo risi e ligjit bën të mundur njohjen me informacione në kohë reale, pa bërë asnjë kérkesë dhe pa pritur gjatë, por thjesht me një klik në faqen e internetit.

Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kérkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni. Kjo do të thotë që më së shumti prej muajit

---

6 Në Vendimin nr. 14, datë 03.02.2015, Komisioneri për të Drejtën e Informimit u shpreh: “Konstatohet se informacioni është dhënë për një prej kërkuesve dhe nuk argumentohet mbi refuzimin e dhënies për konkurrentin tjeter.”

Prill të vitit 2015 të gjithë autoritetet ekzistuese duhet të nisnin nga zbatimi i programeve të transparencës. Përjashtim këtu bëjnë vetëm autoritetet që nuk janë krijuar ende, për të cilët afati 6 muajor nis nga momenti që ato krijohen sipas rastit me ligj, akt nënligjor, ose me kontratë.

Në përgatitjen e projektprogramit të transparencës, autoriteti publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos:

- a) garantimin e *njohjes maksimale* me informacionin publik;
- b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion.

Sipas përcaktimit të ligjit, është e pritshme që autoritetet të publikojnë sa më shumë informacione online. Këtu mund të përmendim dy momente të rëndësishëm:

- Së pari, pritet që të lindë nevoja që çdo kërkues të konsultohet më faqen e internetit të autoritetit përpëra se të bëjë një kërkesë për informacion. Mundësia që informacioni të gjendet në faqen e internetit pritet që të jetë e madhe.
- Së dyti, nëse një informacion/dokument është i publikuar online, nuk do të thotë që kërkuesi nuk ka të drejtë të marrë sërisht kopje të autentikuara të dokumentit. Në këtë rast do të nevojitet një kërkesë standarde, pavarësisht se dokumenti gjendet online.

Në rastet kur një dokument nuk gjendet i publikuar online, në programin e transparencës, dhe ky dokument kërkohet nga një person i interesuar, Komisioneri mund të vendosë të detyrojë autoritetin publik që të verë në dispozicion të kërkuesit një kopje të dokumentit, si dhe të detyrojë autoritetin publik që njëkohësisht të publikojë online dokumentin e kërkuar.<sup>7</sup>

Rishikimi i programit të transparencës do të bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij. Ligji nuk ka përcaktuar asnjë procedurë se si do të miratohet një program transparence, sepse kjo varet shumë nga organizimi i brendshëm i çdo autoriteti. Nëse një program transparence është

---

<sup>7</sup> Një praktikë e tillë është ndjekur në rastin e Vendimit nr. 2, datë 31.12.2014 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit.

miratuar për shembull nga një këshill drejtues, atëherë rishikimi i tij nuk mund të bëhet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm, por vetëm me anë të një vendimi tjetër të këshillit drejtues. Rishikimi i programit të transparencës duhet të bëhet të paktën një herë në 5 vjet, në varësi të natyrës së çdo autoriteti publik.

Modelet e programeve të transparencës ofrohen nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale i cili krijon modele përkategoritë ndryshme të autoriteteve publike.

Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësish të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit, shumica e të cilave janë përshkruar në mënyrë të qartë:

- a) Një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;
- b) Tekstet e plota të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, ligjeve, akteve nënligjore, kodeve të sjelljes, si dhe çdo dokument politikash, manuale ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë (për konventat, ligjet, aktet nënligjore, përcaktimi ligjor ndoshta duke i tepërt, sepse aktualisht këto akte janë publike, pasi hyrja në fuqi e tyre nuk mund të ndodhë pa u publikuar në fletoren zyrtare, por në praktikë haset vështirësi në gjetjen e versioneve të përditësuara të akteve dhe ky problem mund të zgjidhet nga programi i transparencës);
- c) Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- c) Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- d) Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë sipas ligjit<sup>8</sup>, strukturat

---

8 Në Vendimin nr. 5, datë 21.01.2015, Komisioneri për të Drejtën e Informimit shprehet: “Kjo referencë ligjore saktëson që për çdo informacion tjetër të papërfshirë në këtë kategori, domosdoshmërisht duhet bërë balanca

- e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes (përfshirë këtu dosjet e aplikimit për përfitimin e një posti zyrtar), kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- dh) Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrollori i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- e) Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin finanziar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave (rasti i medias publike që financohet pjesërisht nga tarifa e radios dhe televizionit) ose çdo formë tjeter e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;
- ë) Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatesisht, sipas parashikimeve të ligjit nr.9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr.125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura; shumën e kontraktuar; palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme (një pjesë e këtyre informacioneve publikohen në mënyrë të detyrueshme sipas përcaktimeve në legjislativit për prokurimet publike, në portalin [ëë. app.gov.al](http://ëë. app.gov.al));
- f) Informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;

---

*midis lejimit dhe ndalimit të dhënies së informacionit në përputhje me ligjet respektive për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënavë personale. Bërijës së kësaj balance i nënshtrohen në rastin objekt shqyrtime edhe procesverbalet e kërkua e ankuesi. Në përfundim, konstatohet se, balanca e bërë nga autoriteti publik Universiteti “Ismail Qemali” në mënyrë të përmbledhur në përgjigjen e dhënë ankuesit eshtë e bazuar në ligj e ndërsa, objekti i ankesës nuk përputhet me bazën ligjore dhe si e tillë ajo nuk pranohet.”*

- g) Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kérkesave dhe ankesave në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;
- gj) Çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;
- h) Një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kérkesë;
- i) Regjistri i kérkesave dhe përgjigjeve sipas nenit 8, të këtij ligji;
- j) Një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato;
- k) Informacione dhe dokumente që kerkohen shpesh;
- l) Çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik.

Në pamje të parë, lista përmban informacione të dobishme, jo vetëm për të informuar publikun për veprimtarinë e autoriteteve publike. Informacioni mbi kompetencat e zyrtarëve, procedurat e ankimit, mbi kategoritë dhe format e ndihmës shoqërore, subencionet, etj, nuk janë realisht informacione që lidhen me veprimtarinë e kryer prej autoriteteve, por shërbejnë më shumë për të orientuar publikun për të përfituar shërbimet publike në mënyrë më efektive. Në këtë mënyrë programet e transparencës janë një mjet i mirë për publikun që të aksesojë jo vetëm informacionin por edhe vetë shërbimet publike, duke tejkaluar në mënyrë pozitive edhe synimin parësor të ligjit.

Sipas ligjit të ri, autoritetet publike, gjithashtu, krijojnë dhe arkivojnë një kopje digjитale të faqes zyrtare në internet të plotësuar me informacionin që kerkohet në programin e miratuar të transparencës si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kérkesë.

Në mënyrë të veçantë, aktet që përbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe ato me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga autoritetet publike.

Në këtë mënyrë, legjislatori duket se e ka përshtatur mjaft mirë mundësinë që jep zhvillimi i teknologjisë së informacionit për të lehtesar publikun në marrjen e informacioneve të rëndësishme, dhe duke shtuar në të njëjtën kohë barrën e detyrave të autoriteteve publike me një ngarkesë të arsyeshme dhe të realizueshme në një kohë të shkurtër.

### **3. Regjistrimi i kërkesave dhe përgjigjeve (nenet 8, 9)**

Sipas nenit 8 të ligjit, autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik si dhe në mjediset e pritjes së publikut e në mjediset e autoritetit publik.

Ky mjet pritet që të jetë shumë efektiv në lidhje me informimin mbi ecurinë e një kërkeze për informim, pasi:

- Së pari, duke aksesuar këtë regjistër online, çdo person që është interesuar për një informacion ka gjasa që të gjejë se një person tjetër e ka kërkuar më parë dhe se përgjigja tashmë është online;
- Së dyti, kërkuesi mund të njihet me ecurinë e kërkesës së tij në kohë reale;
- Së treti, një kërkuesi mund të marre një herë përgjigje dhe për arsyë të ndryshme mund ta ketë humbur dokumentin, ai mund të shkarkojë online përsëri një kopje tjetër;
- Së katërti, siguron një bazë të mirë informacioni për organizata dhe studiues që përgatisin studime e raporte në lidhje me tema të ndryshme për të drejtën e informimit.

Një element i rëndësishëm është që identiteti i kërkuvesve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër, duke mbrojtur anonimatin e tyre.

Ashtu siç e shpjeguam edhe më sipër, një informacion që i është dhënë një herë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë. Autoriteti publik duhet vetë të bëjë të mundur që informacioni, i cili i është dhënë të paktën një herë një kërkuesi, të bëhet i disponueshëm në mënyrën më praktike të mundshme për të gjithë personat e tjerë që mund ta kërkojnë në të ardhmen, duke rritur transparencën në mënyrë të vazhdueshme.

Kërkesat për informim për informacione të regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve plotësohen jo më vonë se 3 ditë pune nga momenti i paraqitjes së kërkesës. Ky parashikim ligjor, bën të mundur që Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve të plotësohet në mënyrë dinamike dhe me shpejtësi, duke krijuar mjaftueshmë siguri juridike për kërkuesit.

#### **4. Kompetencat e koordinatorit për të drejtën e informimit (neni 10)**

Neni 10 i ligjit, me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e së drejtës së informimit, detyron çdo autoritet publik të caktojë një prej *nëpunësve* si koordinator për të drejtën e informimit. Nga formulimi i dispozitës duket se Koordinatori është me statusin e *nëpunësit civil* dhe nuk mund të ushtrohet si detyrë nga një punonjës i thjeshtë, i cili është marrë në punë në bazë të dispozitatave të Kodit të Punës. Megjithatë emërtesa “*nëpunës*” nuk i referohet në mënyrë strikte personave me status *nëpunësi*. Synimi i ligjvënësit është që të shmangë mundësinë që një autoritet të caktojë si koordinator për të drejtën e informimit një person i cili nuk ka statusin e duhur të *funkcionarit* dhe nuk ka një formim të përshtatshëm për të kryer këtë detyrë delikate. Por në praktikë mund të ndodhë që në strukturën organike nuk ekziston asnjë prej emërtesave që ka status *nëpunësi*. Në këto raste mund të caktohet një punonjës tjetër i përshtatshëm për të kryer këtë funksion.

Meqënëse në kuptimin e autoritetit publik përfshihen edhe subjekte joshtetërore, edhe këta të fundit detyrohen të caktojnë një koordinator për të drejtën e informimit njëlloj si organet publike.

Në parantezë, duhet theksuar se detyra e koordinatorit për të drejtën e informimit është një detyrë mjaft e vështirë dhe e shoqëruar me pasoja (gjoba relativisht të rënda) nëse nuk kryhet me kujdesin maksimal. Detyrat që i ngarkohen këtij funksionari ushtrohen krahas funksioneve të tjera që ai ka pranë autoritetit publik. Ligji ka renditur një sërë kompetencash të këtij funksionari, të cilat janë si më poshtë:

- I mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t'u njohur me informacionin publik, sipas ligjit, duke u konsultuar me dokumentin original ose duke marrë një kopje të tij;

- b) Krijon, mban, publikon dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve brenda afatit të ligjor;
- c) Bashkërendon punën për plotësimin e kërkesave për informacione brenda afateve dhe sipas mënyrës së parashikuar në ligj;
- ç) Regjistron kërkesat për informacion dhe cakton një numër rendor për secilën prej tyre;
- d) Dërgon kërkesën për informim tek një autoritet tjetër publik brenda afateve të parashikuara në ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar;
- dh) Verifikon rastet për dhënien falas të informacionit qytetarëve, sipas parashikimit të ligjit;
- e) Kryen njoftimet paraprake, si dhe komunikon me kërkuesin sipas nevojës për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

NJOHJA ME  
INFORMACIONIN  
PUBLIK

KREU III

## 1. Mënyra e kërkimit të informacionit (neni 11)

Kërkesa për informim mund të bëhet në tre mënyra:

- me shkrim dhe dërgohet dorazi,
- me postë
- ose me postë elektronike,

Kërkesa duhet të përmbajë saktë identitetin e kërkuesit dhe nënshkrimin e tij. Edhe në rast se kërkesa do të dërgohet me postë elektronike, ajo duhet të shoqërohen me këto të dhëna. Në mesazhin me postë elektronike është e lehtë që të përshkruhet identiteti i kërkuesit, por nënshkrimi duket se është një element i domosdoshëm. Aktualisht legjislacioni shqiptar ka njojur mundësinë e nënshkrimit elektronik, por sistemet që garantojnë këtë nënshkrim janë relativisht të komplikuara. Për këtë arsy, nëse kërkohet një informacion me rëndësi të veçantë për kërkuesin, kërkesa duhet të bëhet me shkrim dhe jo me anë të postës elektronike. Mënyra më e shpejtë është ajo e dorëzimit të kërkësës dorazi tek autoriteti publik, por dërgimi me postë është një mënyrë më komode, sidomos në rastet kur selia e autoritetit publik ndodhet në distancë të papërshtatshme (për shembull në një qytet tjeter).

Në çdo rast, kërkesa regjistrohet në *Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve*, brenda 3 ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkësës.

Në çdo rast, në momentin e regjistrimit të kërkësës për informim, asaj i caktohet një numër rendor. Numri rendor, së bashku me të dhënat e kontaktit të koordinatorit për të drejtën e informimit, i jepen kërkuesit që ka bërë kërkësen për informim.

Ligji e ka lënë të paqartë mënyrën se si komunikon koordinatori për të drejtën e informimit në momentin e regjistrimit. Nëse kërkesa bëhet me anën e dorëzimit dorazi të kërkësës me shkrim atëherë numri rendor dhe të dhënat e kontaktit të koordinatorit pritet të merren në momentin e dorëzimit të kërkësës. Në rastin e paraqitjes së kërkësës me postë elektronike pritet një mesazh prej koordinatorit që përmban të dhënat e sipërpërmendura. Ndërsa në rastin e dorëzimit të kërkësës me postë të rregullt, atëherë përgjigja e koordinatorit pritet të kalojë

më shumë hallka burokratike, sepse koordinatori do të duhet të përgatisë një shkresë dhe pasi ta protokollojë atë do ti duhet ta dërgojë me postë te kërkuesi, duke bërë kështu që i gjithë procesi të marrë më shumë kohë. Megjithatë kjo mënyrë mbetet më e sigurtë në rast se do të duhet më pas që çështja t'i nënshtronhet procedurave të ankimit administrativ apo gjyqësor.

Në çdo rast, nëse kërkesa dorëzohet me postë, duhet të sigurohet një kopje e kuponit postar të dërgesës, i cili do të shërbejë si provë për dërgimin e kërkësës. Gjithashtu, në praktikë mund të ndodhë që kërkesa e dërguar me postë të mos protokollohet nga autoriteti publik dhe në këto raste Komisioneri për të Drejtën e Informimit mund të rrëzojë ankesën.<sup>9</sup> Nëse ndodh kështu, mund t'i drejtoheni gjykatës. Kuponi postar ju bën të mundur që të identifikoni dërgimin dhe me anën e një kërkese drejtuar shoqërisë së shërbimit postar mund të identifikoni se kush e ka marrë kërkësën nga autoriteti publik. Në këto raste, nëse kërkesa është dërguar, por nuk është protokolluar, veprimi mund të klasifikohet si një kundravajtje e veçantë, bazuar në legjislacionin për arkivat.

Kërkusat për informim regjistrohen sipas radhës së paraqitjes dhe trajtohen pa dallime mes tyre. Në këtë mënyrë ligji nuk bën dallim nëse kërkesa është paraqitur nga një qytetar i thjeshtë apo një gazetar investigativ, duke i dhënë të gjithëve barazi përpëra ligjit. Kjo nuk presupozon që kërkusat do të marrin përgjigje në të njëjtën rradhë, pasi dhënia e përgjigjes shpesh ndikohet nga sasia dhe lloji i informacionit që kërkohet, i cili mund të jetë i thjeshtë ose i vështirë për t'u përpiluar.

---

9      Në Vendimin nr. 31, datë 05.05.2015, Komisioneri për të Drejtën e Informimit shprehet: “Komisioneri me urdhrin nr. 80, datë 15.04.2015, urdhëroi kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik “Inspektoratit Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit”. Gjatë inspektimit u konstatua se në protokolin e IKMT nuk rezulton të jetë depozituar kërkesa e Qendrës “ResPublica”. Në këto kushte pretendimi i ankuesit për refuzim dhënie informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare nuk qendron”. Pas interesimit të Qendrës Res Publica pranë Postës Shqiptare sh.a. u konstatua se kërkesa është marrë nga autoriteti publik IKMT, por nuk është protokolluar. Çështja i është shtruar për zgjidhje Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

## 2. Përmbajtja e kërkesës për informim (neni 11, pika 4)

Kërkesa për informim duhet të përmbajë:

- a) emrin dhe mbiemrin e kerkuesit; (Ligji nuk përcakton si të detyrueshme paraqitjen e të dhënave të tjera si atësia, amësia, datëlindja apo vendlindja. Në pjesë e parë të nenit 11 ligjvënësi ka përmendur termin “*indentitetin e kerkuesit*”, por pa përmendur të dhëna tëposaçme. Në këtë mënyrë është e paqartë se si do të veprohet në rastin e paraqitjes së kërkesave nga persona të mitur.)
- b) adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni; (Adresa postare duhet të jetë e qartë dhe e plotë. Çdo mangësi në këtë adresë mund të sjellë pasojën që informacioni të mos mbërrijë në adresën e kerkuesit dhe autoriteti shkarkohet nga përgjegjësia. Kërkuesi mund të referojë njëkohësisht të dyja adresat, atë postare dhe atë elektronike, duke përmendur edhe se cila prej të dyjave është prioritare.)
- c) përshkrimin e informacionit që kërkohet; (Ky aspekt paraqet një rëndësi tepër të veçantë. Një informacion i papërshkruar mirë mund të passjellë një përgjigje negative. Kërkesa duhet të jetë koncize, duke kërkuar një informacion sa më tepër konkret që të jetë e mundur, dhe jo me natyrë të përgjithshme. Për shembull, nëse kërkohet informacion rrëth një procedure prokurimi, duhet të referohet saktë se çfarë kërkohet, duke përfshirë procesverbalet e vlerësimit të ofertave, skualifikimit të operatorëve, dokumentet e shpalljes së fituesit, kontratën e nënshkruar, procesverbalin e marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, etj. Por nuk mund të shtrohet pyetje e përgjithshme si për shembull: Si është tenderuar ndërtimi i rrugës Durrës-Kukës? Kjo mënyrë kërkimi nuk është konkrete dhe mund të rezultojë me një përgjigje negative nga ana e autoritetit.)
- ç) formatin në të cilin preferohet informacioni; (Formatet mund të jenë të ndryshëm, kopje fizike e dokumentit, kopje e autentikuar e dokumentit, kopje elektronike e dokumentit, fotografi, material audiovizual, ose edhe material i transkriptuar, etj.) Në qoftë se kërkesa për informim nuk e përcakton formatin në të cilin kërkohet informacioni, ai jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.

- d) çdo të dhënë që kërkuesi gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar. (Të dhëna që ndihmojnë autoritetin për të realizuar në mënyrën më të mirë të mundshme informimin e kërkuesit sipas nevojave të tij specifike)

### **3. Saktësimi dhe trajtimi i kërkesës për informim (*neni 12*)**

Sic e shpjeguam më lart, kërkesa për informim duhet të jetë e qartë dhe e pëershkruar mirë. Por çfarë ndodh nëse kërkesa është e paqartë? Neni 12 i ligjit shprehet se në rastet kur autoriteti publik, të cilit i drejtohet kërkesa për informim, është i paqartë në lidhje me përmbajtjen dhe natyrën e kërkesës, ai nuk e refuzon kërkesën menjëherë, por kontakton fillimisht, jo më vonë se 48 orë nga data e paraqitjes së kërkesës, me kërkuesin për të bërë sqarimet e nevojshme. Në çdo rast, autoriteti publik ndihmon kërkuesin në saktësimin e kërkesës. Në rast se afati prej 48 orësh skadon në një ditë festë apo pushimi zyrtar, ai shtyhet deri në ditën pasardhëse të punës.

Në praktikë mund të ndodhë që autoriteti publik të mos e disponojë dokumentin që kërkohet, pasi ky dokument mund të disponohet nga një autoritet tjetër. Edhe këtë situatë e ka zgjidhur nenit 12 i ligjit, duke përbërë një risi me efekte shumë pozitive. Sipas ligjit tashmë të shfuqizuar, nëse autoriteti publik nuk dispononte dokumentin ai thjesht përgjigjej që nuk e dispononte duke mos e ndihmuar dhe orientuar aspak kërkuesin. Në rastin më të keq, autoriteti nuk përgjigjej brenda afateve ligjore dhe pretendimin se nuk e dispononte dokumentin e paraqiste vetëm në gjykatë, duke bërë që kërkuesi të humbite jo vetëm gjyqin, por edhe kohën e vlefshme, si dhe kostot gjyqësore. Sipas ligjit të ri, në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar (sepse nuk është autoriteti i duhur, ose e ka nisur praktikën te një autoritet tjetër, apo e ka arkivuar pranë Drejtorisë së Arkivit), ai, jo më vonë se 10 ditë pune nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent duke e vënë në dijeni edhe kërkuesin. Pra, edhe nëse kërkuesi nuk e ka të qartë se cili autoritet duhet të disponojë një dokument të veçantë, ai mund ta bëjë kërkesën në autoritetin që e mendon si më të mundshmin, dhe më pas mund të jetë i sigurtë që kërkesa, ndonëse e nisur në adresë të gabuar, do të adresohet tek autoriteti i duhur në

mënyrë automatike. Në këtë rast koordinatori për të drejtën e informimit pranë autoritetit publik, duhet të njoftë mirë sistemin administrativ, duke pasur ide të qarta se cili autoritet e disponon realisht dokumentin, duke përbërë kështu një ndihmesë shumë të madhe përkuesin që nuk i ka idetë e qarta. Megjithatë, koha që do të duhet të pritet një përgjigje në këto raste zgjatet, duke sjellë vonesë (rreth një javë kalendarike).

Një aspekt mjaft i rëndësishëm i trajtuar nga ligji i ri është se, sipas nenit 12, arsyja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës te një autoritet tjetër është *mungesa e informacionit* të kërkuar nga vetë autoriteti i parë. Autoritetit nuk i lejohet që të dërgojë kërkesën për informacion te një autoritet tjetër nëse e disponon edhe vetë kopjen e tij.

Autoriteti publik, të cilit i është drejtuar kërkesa për informim, njofton kërkesin se kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti tjetër si dhe e informon atë për kontaktet e autoritetit ku është dërguar kërkesa.

#### 4. Kostoja e shërbimit (*neni 13*)

Parimisht shërbimet e administratës publike janë pa pagesë. Ky parim është njofur edhe në Kodin e Procedurave Administrative. Por, është e arsyeshme dhe plotësisht e kuptueshme që për të kthyer një përgjigje dhe për të vënë në dispozicion një dokument autoriteti publik do të duhet të përballohet me një kosto. Për këtë arsy, dhënia e informacionit mund të bëhet kundrejt një tarife, e cila është sa kostoja e riprodhimit të informacionit të kërkuar dhe, kur është rasti, e dërgimit të tij. Në rast se informacioni kërkohet në rrugë elektronike autoritetit nuk do i duhet të bëjë fotokopjime dhe as të paguajë dërgimin me postë, prandaj për këtë arsy informacioni i kërkuar në rrugë elektronike jepet *f拉斯*. Kjo mënyrë mund të preferohet kur informacioni është veçanërisht voluminoz dhe kostoja e riprodhimit dhe dërgimit me postë është relativisht e madhe. Për shembull, dosja e procedimit penal nr. 3/2008 (procesi penal për ngjarjen e Gérdecit) përmban mbi 12.000 faqe dhe kostoja e riprodhimit në këtë rast është tepër e madhe dhe gjithashtu e ndjeshme është edhe kostoja e dërgimit me postë për shkak të peshës së konsiderueshme. Në këtë rast dokumentat ekzistojnë edhe në format elektronik (DVD) e cila mund të komunikohet

në rrugë elektronike, duke shmangur kostot e tepërtë dhe duke siguruar njëkohësisht informacionin e kërkuar. Megjithatë, informacioni i komunikuar në rrugë elektronike nuk është i përshtatshëm për t'u përdorur në gjykatë.

Ligji shprehet se kostoja duhet të jetë e përcaktuar më parë dhe e bërë publike nga autoriteti publik në faqen e tij të internetit dhe në mjediset e pritjes së publikut. Në këtë mënyrë shmanget çdo e papritur dhe kërkuesi është i njohur me kostot që do të përballet që përpara se të marrë hapin për të paraqitur kërkesën, duke planifikuar kështu edhe pagesën.

Kostoja e riprodhimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja reale e materialit mbi të cilin riprodhohet informacioni. Kjo do të thotë që autoriteti publik nuk mund të llogarisë në strukturën e kostos edhe kohën e punës së punonjësve për të riprodhuar informacionin.

Kostoja e dërgimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja mesatare e të njëjtit shërbim në treg. Kjo do të thotë që nuk mund të aplikohen tarifa të larta dhe abuzive të dërgesës postare. Autoriteti nuk mund të pretendojë të përdorë dërgimin me *postë të shpejtë* duke e ngarkuar këtë kosto te kërkuesi. Dërgesat do të realizohen me anën e postës normale, e cila ka tarifa mjaft të ulëta dhe shpejtësi komunikimi të favorshme (rreth 2 ditë pune).

Tarifat janë objekt i rishqyrtimit periodik nga Komisioneri për të Drejtë e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, por në çdo rast ato do t'i përbahen parimeve të mësipërme.

Meqënëse jo çdokush është realisht në gjendje të përballojë tarifat, sado të ulëta të jenë ato, pika 4 e nenit 13 të ligjit parashikon përjashtimin nga tarifat për kategoritë caktuara kërkuesish. Qytetarët e regjistruar rregullisht në skemat e ndihmës shoqërore si dhe subjektet përfituese sipas ligjit nr.10039, datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”, e përfitojnë informacionin falas. Përjashtimi nga tarifa mund të shtrihet deri në një numër të caktuar faqesh për çdo kërkesë ose në vlerën ekivalente kur informacioni jepet në një format tjetër. Kufizimi bëhet nga Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave me udhëzim të përbashkët.

Një problem që vihet re në këtë parashikim është se subjektet përfituese të ligjit për ndihmën juridike duhet të vërtetojnë pamundësinë e tyre financiare

me anën e një seti prej më shumë se 10 dokumentash, duke e bërë të vështirë në praktikë. Mbetet gjithashtu e paqartë nëse për këta persona do të merren të mirëqena kriteret përfitimin e ndihmës juridike, thjesht përfekt kategorizimi, apo do të duhet që ata të marrin më parë miratimin e dhënies së ndihmës nga Komisioni Shtetëror përfitimin e ndihmës Juridike. Gjithsesi, siç e shprehëm më lart, ky parashikim ligjor, ndonëse në parim është shumë pozitiv, do të ketë një zbatim të papërfillshëm në praktikë, përfshakat mungesës së leverdisë praktike.

## 5. Mënyrat e dhënies së informacionit (neni 14)

Ligji i ri njeh të gjitha mënyrat e zakonshme të dhënies së informacionit. Kështu në fillim ligji përmend ato informacione që mund të konsultohen pa pagesë në mjediset e autoritetit publik, ose nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet. Këto faqe interneti duhet të konsultohen përpara se të bëhet një kërkesë për informacion, pasi mund të shkurtojë kohë në aksesin ndaj informacionit të kërkuar. Gjithsesi, nëse informacioni gjendet i publikuar online, autoriteti publik përsëri e ka detyrimin përfitimin e një formë të tillë ose mund të konvertohet. Nëse kërkuar preferon informacionin e gjendur online.

Sipas nenit 14 të ligjit, kërkesat, që lidhen me dokumente të shkruara, trajtohen duke vënë në dispozicion të kerkuesit:

- a) një kopje të plotë në format të njëjtë me atë të përdorur nga autoriteti publik, përvèç rasteve të veçanta;
- b) një kopje të plotë të informacionit nëpërmjet postës elektronike, kur informacioni gjendet në një formë të tillë ose mund të konvertohet.

Lidhur me kërkesat që lidhen me forma të tjera, informacioni jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët përfitimin publik. Kjo nuk do të thotë që autoriteti publik ka të drejtë të vendosë dhënien e dokumentit në një format tjetër nga ai i kërkuar, kur bëhet fjalë përfitimin e kopjeve të autentikuara të dokumentave.

Megjithatë, mund të ekzistojnë rrethana të veçanta kur dhënia e dokumentit në formën e kërkuar mund të jetë praktikisht e pamundur, si përfshembull,

kur kërkohet të riprodhohet një hartë në format tepër të madh. Në çdo rast, vendimi i refuzimit për formën e kërkuar jepet me shkrim dhe i arsyetur. Ky vendim, nëse do të gjyket si i paarsyeshëm nga kërkuesi, mund të ankimohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe të Mbrojtjen e të Dhënavë Personale, dhe më pas në gjykatë nëse vendimi i Komisionerit nuk bind kërkuesin.

## **6. Afati për marrjen e informacionit (neni 15)**

Një nga risitë më të rëndësishme të ligjit është shkurtimi i afatit për marrjen e informacionit. Ligji tashmë i shfuqizuar parashikonte një prej 40 ditësh për kthimin e përgjigjes, ndërsa me ligjin e ri autoriteti publik trajton kërkuesin për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar *sa më shpejt që të jetë e mundur*, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj.

Siq vihet re, ligji i ri shprehet në ditë pune. Në ditë kalendarike afati është më i gjatë, duke pasur parasysh se në numërimin e ditëve nuk përfshihen ditët e shtuna dhe të diela, si dhe ditët e festave zyrtare. Afati nis nga dita e nesërme e paraqitjes së kërkessës. Kështu, për shembull, nëse kërkesa është paraqitur më datë 20 tetor 2014 (e hënë), atëherë afati mbaron më 3 nëntor (e hënë). Pra normalisht kohëzgjatja maksimale është rreth dy javë kalendarike. Ky afat mund të jetë pak më i gjatë nëse gjatë afatit janë edhe festa zyrtare.

Megjithatë, ligji lë hapësirë që afatet të janë të ndryshme nëse një ligj i posacëm, në varësi të fushës ku kërkohet informacioni, parashikon afate të ndryshme. Shembull është ligji për prokurimin publik, i cili parashikon afatin prej 5 ditësh për personat që janë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Ligjet e posaçme aplikohen vetëm në rrethana shumë të veçanta dhe zbatimi i tyre nuk paraqet përdorim të gjerë në praktikë.

Mirëpo, afati i mësipërm nuk zbatohet nëse autoriteti publik e disponon vetë dokumentin. Kur autoriteti publik që merr kërkuesin për informim, nuk e disponon dokumentin dhe ia dërgon kërkessë një autoriteti tjetër, ky i fundit kthen përgjigje jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga dita e mbërritjes së kërkessës në autoritetin e parë.

Siç shihet, afati llogaritet përsëri duke nisur nga data e kërkesës fillestare që është paraqitur në autoritetin e parë. Kështu, autoriteti i parë do të duhet të veprojë shpejt dhe pa humbur kohë, sepse koha që i lihet autoritetit të dytë është vetëm 5 ditë pune më shumë. Ligji nuk sqaron se çfarë mund të ndodhë nëse edhe autoriteti i dytë nuk e disponon dokumentin, dhe kërkesa i është dërguar gabim nga autoriteti i parë, në bazë të bindjes së gabuar të koordinatorit për të drejtën e informimit pranë atij autoriteti. Në këto raste, mund të interpretohet se detyrimi për të gjetur autoritetin e saktë që disponon dokumentin është përsëri i autoritetit të parë dhe jo i autoritetit të dytë, për të shmangur dërgimin e kërkesës në mënyrë zinxhir nga një autoritet në tjetrin dhe pa arritur rezultat. Për këtë arsy, çdo koordinator është i detyruar që të tregojë kujdes të veçantë për të adresuar kërkesën në një autoritet tjetër, dhe jo thjesht ta pasojë atë, duke shmangur përgjegjësinë administrative.

Afati i parashikuar më sipër (sipas rastit ai 10 ditor, apo ai 15 ditor) nuk është një afat i pandryshueshëm. Këto afate mund të zgjaten me jo më shumë se 5 ditë të tjera pune vetëm për shkaqe tepër të veçanta, të cilët janë:

- a) Nevoja për të kërkuar dhe shqyrta dokuamente të shumta e voluminoze;
- b) Nevoja për t'i shtrirë kërkimet në zyra dhe mjetet që janë fizikisht të ndara nga zyra qendrore e autoritetit;
- c) Nevoja për t'u konsultuar me autoritete të tjera publike përparrë marrjes së një vendimi për plotësimin ose jo të kërkesës.

Në çdo rast, vendimi për zgjatjen e afatit i njoftohet menjëherë kërkuesit, i cili duhet të njihet se çfarë po ndodh me kërkesën e tij.

Ashtu si në ligjin e mëparshëm, edhe në ligjin e ri parashikohet se në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës për informim brenda afateve të sipërpërmendura do të konsiderohet refuzim. Pra refuzimi mund të jetë dy llojesh:

- *i shprehur*, ku autoriteti shprehet në mënyrë të arsyetuar se e refuzon dhënien e informacionit pasi sipas tij ekziston një nga pengesat ligjore;
- *në heshtje*, në rast se autoriteti nuk përgjigjet brenda afateve.

Edhe nëse autoriteti do të përgjigjet në tejkalim të afateve, përsëri mospërgjigja në kohën e duhur mund të konsiderohet si refuzim. Por, nëse pas marrjes së informacionit kërkuesi do të ushtrojë të drejtën e tij të ankimit administrativ, apo

gjyqësor, mund të ndodhë që Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të mos detyrojë autoritetin për të dhënë informacionin, pasi tashmë ky detyrim është ezauruar, pavarësisht faktit se ezaurimi është bërë me vonesë. Por, në këto raste, koordinatori përgjegjës do të gjobitet dhe kërkuesi ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e démit të shkaktuar nga vonesa.

Një aspekt me rëndësi në ligjin e ri, ka të bëjë me zbatimin e afateve të sipërpërmendura edhe për njohjen me informacionin arkivor të çdo lloji. Në praktikë mund të ndodhë që materialet arkivore të janë tejet voluminoze, në formate audiovizuale të paaksesueshme me anë të teknologjive normale, apo të janë të organizuara keq, por këto nuk do të janë shkaqe për pengimin e aksesit në këto materiale arkivore. Në mënyrë të tërthortë, ligji i ri do të ketë një efekt pozitiv në organizimin e arkivave dhe bërjen e tyre më të aksesueshme për publikun.

## 7. Njoftime paraprake për kërkuesin (*neni 16*)

Neni 16 i ligjit parashikon që në qoftë se autoriteti konstaton se trajtimi i një kërkese për informim ka kosto të lartë ose se trajtimi i saj kërkon më shumë kohë se afati i parashikuar në ligj (10 ditë pune), autoriteti publik njofton menjëherë për këtë kërkuesin dhe i propozon mundësinë e ndryshimit të kërkuesës së tij. Kjo dispozitë i jep të drejtën autoritetit që të negociojë një zgjidhje tjeter për të informuar kërkuesin në mënyrë efektive, por nuk do të thotë që kërkuesi është i detyruar t'i përgjigjet pozitivisht ftesës së autoritetit për të rishikuar kërkuesën për informacion. Me anën e këtij instrumenti, autoriteti ka të drejtë të bisedojë me kërkuesin në mënyrë që të shmanget kërkuesat e tepërtë e të panevojshme, duke ofruar informacion për atë që realisht kërkuesi është i interesuar, në një mënyrë njëloj efektive për kërkuesin, por më të favorshme për autoritetin.

Për shembull, kërkuesi është i interesuar të njihet me procesin e dëmshpërbimit të të përndjekurve dhe paraqet një kërkësë për informim. Në kërkuesën e tij ai kërkon të njihet me të gjitha dosjet e dëmshpërblimeve, por ky informacion është shumë voluminoz, që kërkon një volum të madh pune për t'u mbledhur dhe ka kosto të madhe fotokopjimi. Kështu autoriteti ka të drejtë që të nisë një negociatë me kërkuesin për të kufizuar informacionin e kërkuar dhe për të parë realisht mundësinë e ndryshimit të kërkuesës. Mund të ndodhë që

kërkuesit realisht i intereson të dijë se sa persona kanë përfituar këstин e dytë të dëmshpërblimit. Ky rishikim i kërkuesës është më i qartë dhe lehtëson autoritetin në përgatitjen e informacionit brenda afateve ligjore, si dhe përmbush nevojën e kërkuesit për të marrë atë informacion që realisht i intereson atij.

Një lehtësi tjetër që mund të kërkojë autoriteti është në rastin kur informacioni i kërkuar në format elektronik gjendet në internet. Në këtë rast autoriteti publik i tregon menjëherë kërkuesit adresën e saktë të faqes se ku mund të gjendet informacioni (duke i referuar linkun). Por, kur informacioni nuk kërkohet në format elektronik, autoriteti publik nuk mund t'i përgjigjet kërkuesës duke i treguar kërkuesit thjeshte një adresën të faqes ku informacioni gjendet në formë elektronike. Në këtë rast, autoriteti është i detyruar të përmbushë kërkuesën duke dorëzuar informacionin në formatin e kërkuar.

Menjëherë pas marrjes së kërkuesës për informim, autoriteti publik llogarit shumën që duhet paguar për riprodhimin dhe, sipas rastit, për dërgimin e informacionit dhe njofton menjëherë kërkuesin. Dispozita nënkupton që kërkuesi do të njihet me koston përpara se ta marrë informacionin. Nëse kostoja është e lartë, kërkuesi ka gjithmonë të drejtën të rishikojë kërkuesën e tij dhe madje edhe të heqë dorë prej saj, nëse kostoja është pa leverdi për informacionin e kërkuar, sidomos kur motivet personale të kërkimit të tij janë të një rëndësie të papëfillshme. Gjithsesi, kjo nuk vlen në rastin e dërgimit të informacionit në rrugë elektronike, sepse në këtë mënyrë dhënia e informacionit është falas, përveçse edhe më komode.

KUFIZIMI I SË<sup>2</sup>  
DREJTËS PËR  
INFORMIM

**KREU IV**

## 1. Kufizimet (neni 17)

Liria e informimit nuk është e pakufizuar. Kufijtë e vërtetë të kësaj lirie janë përcaktuar në mënyrë parimore në nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili shprehet:

*“2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtronhet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, 6 Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut në interes të sigurisë kombëtare, integrititet territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”*

Formalitetet, kushtet, kufizimet ose sanksionet janë të lejueshme në kuadër të kufizimit të lirisë së informimit, duke plotësuar kushtet e mëposhtme:

- Së pari, kufizimi duhet të ketë bazën e vet në një *ligj të veçantë*, siç është ligji i ri për të drejtën e informimit. Asnjë kufizim që nuk parashikohet në ligj si i tillë nuk mund të shërbejë si shkak për kufizimin e të drejtës për informim.
- Së dyti, kufizimi duhet të jetë *i nevojshëm* në një *shoqëri demokratike*. Në shumicën dërrmuese të rasteve që trajtohen në praktikë, kjo kërkesë e përcaktuar në nenin 10 të Konventës, është një “golden goal” i vërtetë. Informacioni kufizohet nëse është parashikuar me ligj dhe nëse i shërben një prej qëllimeve legjitime të tilla si siguria kombëtare ose mbrojtja e dinjitetit ose e të drejtave të të tjerëve. Këto kërkesa duhet patjetër ti nënshtronhen testit të nevojës në një shoqëri demokratike, domethënë në një shoqëri që respekton dhe ushqen “pluralizmin, tolerancën dhe hapjen e mendjes”. Për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje, autoriteti, Komisioneri për të Drejtën e Informimit, apo edhe gjykatat duhet të shqyrtojnë nëse në kontekstin e rastit kufizimi është apo jo “*i nevojshëm*”, me fjalë të tjera nëse kufizimi synon të adresojë ndonjë “*nevojë sociale urgjente*”. Një faktor shtesë që merret parasysh është identiteti i kërkuesve. Nëse kërkuesi është një gazetar, autoriteti do të ketë parasysh rolin e veçantë që luan shtypi në një shoqëri demokratike.

Sic përcakton neni 17 i ligjit të ri, e drejta e informimit kufizohet në një sërë rastesh, të ndara për qëllime praktike nga ligji në 4 kategori:

- Për mbrojtjen e interesave private ku përfshihen të dhënat personale<sup>10</sup>, sekreti tregtar, pronesia intelektuale dhe industriale (patentat);
- Për mbrojtjen e interesave shtetërore, ku përfshihen siguria kombëtare; për mbarëvajtjen e hetimeve penale, administrative ose proceseve gjyqësore; për mbarëvajtjen e procedurave të inspektimit dhe auditimit, formulimin e politikave monetare dhe fiskale; të këshillimeve dhe diskutimeve paraprake për zhvillimin e politikave publike, apo në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare ose ndërqeveritare;
- Për mbrojtjen e sekretit profesional;
- Për shkak të pamundësisë që rrjedh nga paqartësia së kërkesës;

Kështu, në lidhje me **kategorinë e parë**, e drejta e informimit kufizohet në rast

---

10 Në Vendimin nr. 17, datë 13.02.2015, Komisioneri për të Drejtën e Informimit ka rrëzuar kërkesën për vënien në dispozicion të listëpagesave dhe listëprezencave të një pedagogeje për disa vite. Sipas Komisionerit: *“Rezulton se dokumentacioni i kërkuar i përket periudhave të gjata kohore dhe në përmbytje të tij gjenden të dhëna personale. Në përpunhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, të dhënat personale mbahen për aq kohë sa përfundon qëllimi për të cilin ato janë mbledhur. Në përfundim të përbushjes së qëllimit nga kontrolluesi, Universiteti, të dhënat personale duhet të shkatërrohen apo të kodohen nëse autoriteti publik vlerëson mbajtjen e tij për të tjera qëllime të argumentuara duke bërë me dije edhe subjektin e të dhënave personale. Gjithashtu, për çdo të dhënë sensitive të evidentuar në dokumentacionin e kërkuar, sic mund të jetë identifikimi i raporteve mjekësore, autoriteti publik detyrohet të kryejë përpunimin e tyre vetëm me pëlqimin e subjektit të të dhënave personale apo për përbushjen e një detyrimi ligjor të autoritetit publik, Universitetit.”* Në një rast të kundërt, në Vendimin nr. 6, datë 21.01.2015, Komisioneri për të Drejtën e Informimit shprehet *“Lidhur me dokumentacionin e kërkuar nga ankuesi “Pasqyra financiare të të gjitha pagesave të kryera nga CEZ Shpërndarje kundrejt kompanive të sipërpërmendura ... të ndara në llojet e debisë që këto kompani kanë mbledhur, si p.sh.(familjarë, biznese, institucionë publike, etj.)” dhe të refuzuar nga OSHEE, dhënia e dokumentacionit nuk sjell shkelje të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale por detyrim të zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit për dhënie të dokumentacionit të kërkuar për këto kategori.”*

se është e domosdoshme, *proporcional*<sup>11</sup> dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm:

- a) Të drejtën për një jetë private<sup>12</sup>;
- b) Sekretin tregtar;
- c) Të drejtën e autorit;
- ç) Patentat.

Kufizimi i së drejtës së informimit për shkak të interesave të parashikuar më sipër nuk zbatohet kur titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë *pëlqimin* për dhënien e informacionit përkatës ose kur në momentin e dhënies së informacionit ai është konsideruar autoritet publik në bazë të parashikimeve të këtij ligji. Për shembull, në rastin e pjesëmarrjes në një procedurë të prokurimit publik, shoqëritë konkuruuese nënshkruajnë një *shtojcë të posaçme* ku rendisin dokumentet që ato kërkojnë të mbeten konfidenciale. Çdo dokument që nuk është përfshirë në këtë listë dhe që është dorëzuar prej shoqërisë tregtare private mund të bëhet publik. Në këtë rast konsiderohet se shoqëria tregtare ka dhënë *pëlqimin* e saj për mosruajtjen e konfidencialitetit për dokumentet e papërfshirë në listë.

Pra, kufizimi i të drejtës së informimit kërkon plotësimin e të tre kushteve së bashku: (1) është i domosdoshëm; (2) është proporcional, dhe (3) dëmton një prej katër interesave të renditur më lart në pikat a, b, c dhe ç. Nëse njëri nga kushtet nuk plotësohet atëherë informacioni duhet të bëhet publik.

Nëse kufizimi është i domosdoshëm, por jo proporcional (jo në raport të drejtë me nevojën e diktuar) atëherë aksesi në informacion nuk duhet të kufizohet

- 11 Proporcionaliteti është një parim i përgjithshëm ligjor, i cili përdoret si kriter i ndershmërisë dhe drejtësisë në proceset ligjore të interpretimit, sidomos në të drejtën kushtetuese, si një metodë logjike me qëllimin për të ndihmuar në gjetjen e një ekilibri të saktë në mes të nevojës për të marrë masa kufizuese dhe cenimit që i vjen të drejtës, në varësi nga natyra e saj dhe rr Ethanat në të cilat ajo ushtrohet.
- 12 Në Vendimin nr. 15, datë 03.02.2015, Komisioneri për të Drejtën Informimit rrëzoi kërkesën për vënien në dispozicion të kërkuesit të të dhënave të krijuara nga Rektorati i Universitetit të Tiranës për verifikimet e hyrje-daljeve nga territori i Republikës së Shqipërisë për të tjerë punonjes të UT-së, pasi ky informacion i nënshtronhet kufizimeve të përcaktuara në nenin 17/l/a të ligjit nr. 119/2014.

(ose të paktën pjesërisht). Neni 17 shprehet konkretisht se, pavarësisht nga sa parashikohet në këtë pikë, informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij. Kjo nënkupton që arsyet e dhëna nga autoritetet për të imponuar një kufizim mbi të drejtën e informimit duhet të jenë *relevante dhe të mjaftueshme* dhe se kufizimi duhet të jetë *në proporcione me qëllimin legjitim të ndjekur*<sup>13</sup>.

Në lidhje me **kategorinë e dytë**, e drejta për informim kufizohet në rast se kufizimi është i domosdoshëm, proporcional dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm:

- a) Sigurinë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni për informacionin e klasifikuar;
- b) Parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale<sup>14</sup>;
- c) Mbarëvajtjen e hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor;
- ç) Mbarëvajtjen e procedurave të inspektimit dhe auditimit të autoriteteve publike;
- d) Formulimin e politikave monetare dhe fiskale të shtetit;
- dh) Barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor;

---

13 Në Vendimin nr. 6, datë 21.01.2015, Komisioneri për të Drejtën e Informimit shprehet: “...OSHEE në përgjigjen e dhënë për refuzim të dokumentacionit, duhet të argumentonte dhe bënte balancën, në referim të parashikimeve ligjore të kufizimeve në dhënien e informacionit, sipas nenit 17 të ligjit për të drejtën e informimit, në të cilin parashikohen edhe rastet përjashtimore për dhënie të tij për interes të rëndësishëm publik. Lidhur me argumentimin e OSHEE-së se “Kopjet e kontratave për mbledhjen e borxhit të lidhura midis CEZ Shpërndarje sh.a dhe kompanive të lartpërmendura” përbajnjë në to ose shoqërohen nga marrëveshje konfidencialiteti për ruajtjen e të dhënavë, kjo nënkupton formën e duhur dhe parashikimet ligjore që duhet të përbajë kontrata në një marrëdhënie kontraktuale dhe nuk mund të përdoret si kusht apo kriter për mos dhënie të informacionit.”

14 Me Vendimin nr. 33, datë 13.05.2015, Komisioneri për të Drejtën e Informimit ka rrëzuar kërkesën për vënien në dispozicion të kërkuesit të provave materiale që ndodheshin në një dosje hetimore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat.

- e) Këshillimin dhe diskutimin paraprak brenda ose midis autoriteteve publike për zhvillimin e politikave publike; (në këtë kontekst janë përfshirë bisedimet e lira midis zyrtarëve, të cilët edhe mund të mbajnë qendrime në dukje të gabuara në kuadër të analizës së proporcionalitetit për një vendimmarje të caktuar. Këto këshillime e diskutime paraprake nuk janë finale dhe nuk kanë efekte ligjore, përveç se ndikojnë në bindjen e brendshme dhe në ngjizjen paraprake të një arsyetimi të mëvonshëm nga ana e organit vendimmarrës. Për shembull, bisedimet e gjyqtarëve në një dhomë këshilli para se të marrin vendimin janë konfidenciale dhe kështu nuk mund të bëhen publike. Qendrimi zyrtar i gjyqtarëve në momentin e marrjes së vendimit mund të ndodhë që të ndryshojë tërësisht, duke reflektuar mbi këshillat e dhëna anasjelltas mes tyre, kështu që të gjitha bisedat paraprake janë jorelevante në raport me arsyetimin zyrtar, i cili prodhon realisht pasojat juridike)
- ë) Mbarëvajtjen e marrëdhënieve ndërkombëtare ose ndërqeveritare. (Këtu përfshihen gjithashtu bisedimet dhe këshillimet *jozyrtare* dhe paraprake, duke mos kufizuar detyrimin për të bërë publikë më pas protokollet zyrtarë)

Njëloj si në rastin e kategorisë së parë, pavarësisht nga sa parashikohet më sipër, informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij.

Kufizimi mbi të drejtën e informimit për shkak të mbarëvajtjes së hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor dhe mbarëvajtjes së procedurave të inspektimit dhe auditimit të autoriteteve publike, nuk zbatohet kur hetimi administrativ *ka përfunduar*.

Kufizimi mbi të drejtën e informimit për shkak të mbrojtjes së formulimit të politikave monetare dhe fiskale të shtetit, si dhe të barazisë së palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjes së procesit gjyqësor, nuk zbatohet kur të dhënat përkatëse janë *fakte, analiza të fakteve, të dhëna teknike ose të dhëna statistikore*.

Kufizimi mbi të drejtën e informimit për shkak të mbrojtjes së këshillimeve dhe diskutimeve paraprake brenda ose midis autoriteteve publike për zhvillimin e politikave publike, nuk zbatohet pasi politikat janë bërë publike.

Në përgjithësi, mbi të gjitha kategoritë të cilat përbëjnë *proses*, kufizimi shtrihet vetëm në kohën kur procesi është *në zhvillim*. Kufizimi bie kur procesi ka përfunduar dhe nuk mund të cenohet asnjë vendimmarrje që është ende në proces.

Në lidhje me **kategorinë e tretë**, e drejta e informimit kufizohet nëse është e domosdoshme, proporcionale dhe në qoftë se përhapja e informacionit do të shkelte sekretin profesional të garantuar nga ligji. Sekreti profesional lidhet me shumë profesione që u mundësojnë profesionistëve të grumbullojnë *të dhëna sensitive* të klientëve/pacientëve, ku këta të fundit duhet të janë të sigurtë që të dhënat e tyre nuk do të publikohen dhe keqpërdoren. Këtu mund të sillen shumë shembuj, si psikologu që mbledh të dhëna mbi manitë, fobitë, devijacionet, deliret, etj, të individëve të ndryshëm, ose si avokati, i cili mbledh të dhëna nga komunikimet me klientët që janë të prirur të kenë një dozë më të lartë të sinqueritetit, apo si mjeku, i cili mbledh të dhëna për sëmundjet apo gjendjet fiziologjike të pacientëve, të cilat mund të dëmtojnë imazhin e tyre nëse publikohen.

Këto informacione mbrohen për të mbrojtur të dy palët, profesionistin dhe klientin. Profesionisti mbrohet duhet iu garantuar premisa e duhur për krijuar marrëdhënien e besimit të domosdoshëm me klientin, ndërsa ky i fundit mbrohet nga publikimi i të dhënavë sensitive, publikimi i të cilave mund të sjellë pasoja negative dhe të pariparueshme sociale.

Në lidhje me **kategorinë e katërt**, e drejta e informimit kufizohet edhe kur, pavarësisht nga ndihma e dhënë nga autoriteti publik, kërkesa mbetet e paqartë dhe bëhet i pamundur identifikimi i informacionit të kërkuar. Ky kufizim synon të mbrojë autoritetet dhe veçanërisht koordinatorët për të drejtën e informimit, të cilët mund të vihen në vështirësi objektive nga një kërkessë e paqartë, ose për një informacion të pidentifikueshëm. Ligji kërkon si parakusht që autoriteti të kenë bërë përpjekje për të dhënë ndihmën e tij. Vetëm nëse kërkuesi nuk reflekton mbi propozimin e arsyeshëm të autoritetit, ky i fundit ka të drejtë të refuzojë plotësimin e kërkuesës.

## 2. Rishikimi i klasifikimit të dokumenteve “sekret shtetëror” (neni 17, pika 5)

Një risi me rëndësi të veçantë e ligjit të ri është se sipas nenit 17, pika 6 të ligjit, e drejta e informimit nuk refuzohet automatikisht kur informacioni i kërkuar

gjendet në dokumente të klasifikuara “*sekret shtetëror*”. Në këtë rast, autoriteti publik, të cilil i është dërguar kërkesa për informim, fillon menjëherë procedurën e rishikimit të klasifikimit pranë autoritetit publik që ka urdhëruar klasifikimin. Autoriteti publik njofton menjëherë kërkuesin për fillimin e procedurës për *rishikimin e klasifikimit* dhe vendos shtyrjen e afatit për dhënien e informacionit brenda 30 ditëve pune. Në çdo rast, vendimi për trajtimin ose jo të kërkesës për informim merret dhe arsyetohet në bazë të kritereve të këtij neni<sup>15</sup>.

Kjo dispozitë synon të paraqesë një koncept të ri, që një dokument nuk mund të mbetet sekret pa arsy, nëse ka një kërkesë për t'u bërë publik. Shembulli më tipik janë dosjet sekrete të periudhës së diktaturës, të cilat kanë kaluar periudhën e mbrojtjes ligjore dhe nuk kanë më asnjë impakt në cenimin e interesit të sigurisë kombëtare. Ky parashikim i ri ligjor mund të jetë një instrument efektiv për të aksesuar, qoftë edhe pjesërisht, këto dosje, për herë të parë pas 24 vjetësh.

### **3. Aksesi i pjesshëm në informacion (neni 17, pika 6)**

Një tjetër risi tepër e rëndësishme është që nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kérkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuesit. Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij nenit 17 është bërë ky refuzim.

Në praktikë ndodh që shumë dokumente refuzohen të publikohen vetëm për shakat të një fjalë, rreshti apo paragrafi. Tashmë ligji i ri e ka shmangur mundësinë e refuzimit për të gjithë dokumentin, ose për të gjithë dosjen, duke i dhënë mundësinë autoritetit publik që të mbulojë/errësojë pjesë të caktuara, duke bërë

---

15 Në Vendimet nr. 7, 8 dhe 9, datë 23.01.2015, Komisioneri për të Drejtën e Informimit ka vendosur të detyrojë Shërbimin Informativ Shtetëror, Drejtoren e Përgjithshme të Policisë dhe Prokurorinë e Përgjithshme që të nisë procedurën e riklasifikimit të informacionit të klasifikuar dhe të njoftojë shtyrjen e kthimit të përgjigjes me një afat deri në 30 ditë. Pas riklasifikimit, Prokuroria e Përgjithshme bëri informacionin, duke njofuar numrin e përgjimeve telefonike të kryera në vitin 2014.

publike pjesën tjeter të dokumentit, në përbushje të kërkesës për informim<sup>16</sup>. Në mënyrë të përsëritur, ligji thekson se kufizimet dhe përjashtimet nga kufizimet, zbatohen njëloj edhe për njohjen me informacionin arkivor të çdo lloji, pavarësisht nga parashikimet e ligjit për arkivat.

- 
- 16 Në Vendimin nr. 22, datë 24.03.2015, Komisioneri për të Drejtën e Informimit shprehet: “Më datë 10.03.2015, me shkresën nr.946 Prot., Autoritetit Publik, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, drejtar Komisionerit, shprehet se “në regjistrin e protokollit figurojnë letërkëmbime me pacientët që i referohen sëmundjeve të tyre ose barnave specifike të cilat përbajnë të dhëna sensitive dhe mbrohen nga ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënavë personale”, i ndryshuar, dhe kërkon mendim nga Zyra e Komisionerit se si duhet të procedojnë në këtë rast. Komisioneri me shkresen nr. 199/3, datë 24.03.2015 shprehet se dokumentacioni i kërkuar duhet vlerësuar nga Autoriteti Publik në përputhje me nenin 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” si dhe me nenin 7 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënavë personale”, i ndryshuar. Në rast se Autoriteti Publik vlerëson se informacioni përmban të dhëna sensitive me referencë emër dhe mbiemër të pacientit dhe nëse me të lidhet edhe diagnoza dhe/ose mjekimi përkatës atëherë dokumenti i kërkuar duhet dhënë i anonimizuar.”



SHKELJET DHE  
SANKSIONET  
ADMINISTRATIVE

KREU V

## 1. Kundërvajtjet administrative (neni 18)

Ligji i mëparshëm parashikonte mundësinë e sanksioneve për kundravajtjet administrative, por në praktikë nuk u aplikuan asnjëherë sanksione për shkak se ligji nuk kishte adresuar asnjë aspekt teknik dhe i kishte deleguar të gjitha këto zgjidhje tek aktet nënligjore që nuk u miratuan kurrë.

Ligji i ri parashikon deri në detaje çdo aspekt të nevojshëm për të bërë të mundur zbatimin e sanksioneve administrative. Kështu, mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji passjell përgjegjësi administrative, për kundravajtjet administrative për veprimet dhe mosveprimet e mëposhtme:

- a) Refuzimi i informacionit në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji; (vlen në rastin e refuzimit të paarsyeshëm, ose të moskthimit të përgjigjes brenda afateve ligjore.)
- b) Mosvënia në zbatim e programit institucional të transparencës brenda afatit ligjor;
- c) Mosrishikimi i programit institucional të transparencës brenda afatit ligjor;
- c) Mosndjekja e procedurave për rishikimin e programit institucional të transparencës;
- d) Moskrijimi, mosmbajta, mospublikimi apo mospërditësimi i Regjistratit të Kërkesave dhe Përgjigjeve brenda afatit ligjor;
- dh) Mosplotësimi i kërkesave për informacione të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve brenda afatit dhe sipas mënyrës të parashikuar në ligj;
- e) Mosregjistrimi i kërkesës për informim, moscaktimi i një numri rendor për të dhe mosdhënia e të dhënavë të kontaktit të koordinatorit për të drejtën e informimit;
- ë) Mosdërgimi i kërkesës për informim tek një autoritet tjetër publik brenda afatit ligjor;
- f) Dërgimi i kërkesës për informim tek një autoritet tjetër publik kur autoriteti që ka marrë kërkesën e ka informacionin e kërkuar;
- g) Mosnjoftimi i kërkuesit se kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti tjetër dhe kontaktet e nevojshme i janë dërguar autoritetit tjetër;
- gi) Mospërcaktimi paraprakisht i një tarife ose caktimi i tarifave abuzive për riprodhimin dhe dërgimin e informacionit;

- h) Mosrespektimi i ligjit, për dhënen falas të informacionit (në raste kur kjo aplikohet);
- i) Refuzimi i paarsyetuar i preferencës së kërkuesit për mënyrën e dhënes së informacionit;
- j) Mosnjoftimi i kërkuesit për vendimin për zgjatjen e afatit për plotësimin e kërkesës për informim;
- k) Moskryerja e njoftimeve paraprake (këshillimet dhe propozimet ndaj kërkuesit);
- l) Dëmtimi ose shkatërrimi i dokumenteve zyrtare me qëllim shhangjen e së drejtës për informim (mund të përbëjë gjithashtu edhe vepër penale);
- ll) Moszbardhja e dokumenteve zyrtare në kundërshtim me rregullat në fuqi me qëllim pengimin e ushtrimit të së drejtës për informim (mund të përbëjë gjithashtu edhe vepër penale).

Procedurat e konstatimit, shqyrimit, ankimit dhe ekzekutimit të kundërvajtjeve administrative rregullohen nga ligji nr.10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, duke plotësuar kështu kuadrin ligjor në mënyrë efektive.

Gjobat vendosen nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit. Në muajt e parë të zbatimit të ligjit nr. 119/2014, Komisioneri për të Drejtën e Informimit nuk ka aplikuar gjoba, pasi ligji parashikon se me gjobë penalizohen koordinatorët e të drejtës së informimit dhe gjatë 6 muajve të parë pas miratimit të ligjit, këta koordinatorë nuk ishin caktuar ende. Pas caktimit të koordinatorëve ka nisur aplikimi i gjobave.<sup>17</sup>

## 2. Përgjegjësia administrative (neni 19)

Për të siguruar funksionimin e plotë të sanksioneve ligjore, ligji i ri përcakton qartë edhe se kujt i takon përgjegjësia administrative, pra cili është personi përgjegjës për secilën shkelje.

Sipas ligjit personat përgjegjës ndahen në tre kategori:

---

<sup>17</sup> Me Vendimin nr. 32 datë 11.05.2015, koordinatori për të drejtën e informimit në IKMT është ndëshkuar me 150.000 lekë gjobë.

- Titullari i autoritetit public
- Koordinatori për të drejtën e informimit pranë autoritetit public
- Çdo nëpunës i autoritetit publik

a. Titullari i autoritetit publik mban përgjegjësi ligjore - administrative për shkeljet administrative të mëposhtme:

- Mosvënien në zbatim e programit institucional të transparencës brenda afatit ligjor;
- Mosrishikimin e programit institucional të transparencës brenda afatit ligjor;
- Mosndjekjen e procedurave për rishikimin e programit institucional të transparencës;
- Mospërcaktimin paraprakisht të një tarife ose caktimi i tarifave abuzive për riprodhimin dhe dërgimin e informacionit;

Titullari i autoritetit publik mund ta delejgojë kompetencën e tij për ushtrimin e funksioneve të mësipërme te nëpunësi më i lartë civil i autoritetit publik. Në këtë rast, nëpunësi më i lartë civil mban përgjegjësi ligjore për shkeljet administrative të parashikuara më sipër.

b. Koordinatori për të drejtën e informimit ka barrën më të rëndë. Ai ka përgjegjësi administrative, për shkeljet e mëposhtme:

- Refuzimin e informacionit në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji;
- Moskrijimin, mosmbajtjen, mospublikimin apo mospërditësimin e Regjistrat të Kérkesave dhe Përgjigjeve brenda afatit ligjor;
- Mosplotësimin e kérkesave për informacione të regjistruar në Regjistrin e Kérkesave dhe Përgjigjeve brenda afatit dhe sipas mënyrës të parashikuar në ligj;
- Mosregjistrimin e kérkesës për informim, moscaktimin e një numri rendor për të dhe mosdhënia e të dhënavë të kontaktit të koordinatorit për të drejtën e informimit;
- Mosdërgimin e kérkesës për informim tek një autoritet tjetër publik brenda afatit ligjor;

- Dërgimin e kërkesës për informim tek një autoritet tjeter publik kur autoriteti që ka marrë kërkesën e ka informacionin e kërkuar;
- Mosnjoftimin e kërkuesit se kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti tjeter dhe kontaktet e nevojshme i janë dërguar autoritetit tjeter;
- Mosrespektimin e ligjit, për dhënien falas të informacionit;
- Refuzimin e paarsyetuar të preferencës së kërkuesit për mënyrën e dhënies së informacionit;
- Mosnjoftimin e kërkuesit për vendimin për zgjatjen e afatit për plotësimin e kërkesës për informim;
- Moskryerjen e njoftimeve paraprake;

c. Çdo nëpunës i autoritetit publik, në varësi të rrethanave, mund të ketë përgjegjësi për shkeljet administrative të mëposhtme:

- Dëmtimin ose shkatërrimin e dokumenteve zyrtare me qëllim shmangjen e së drejtës për informim;
- Moszbardhjen e dokumenteve zyrtare në kundërshtim me rregullat në fuqi me qëllim pengimin e ushtrimit të së drejtës për informim.

### **3. Marrëdhëniet [e Komisionerit] me Kuvendin (neni 20)**

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale raporton në Kuvend ose në komisionet parlamentare të paktën një herë në vit ose sa herë që kërkohet prej tyre. Gjithashtu, ai mund t'i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që i çmon të rëndësishme. Raporti përmban të dhëna dhe shpjegime për zbatimin e së drejtës për informim në Republikën e Shqipërisë, si dhe programet e transparencës.

Komisionerit nuk i lejohet njoftimi për çështje konkrete, me përjashtim të çështjeve të kërkuar me vendim të Kuvendit.

Gjatë përpilimit të raportit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbledh të dhëna nga autoritetet publike dhe nga *organizatat jofitimprurëse* që kanë për mision mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut duke evidentuar komunikimet përkatëse.

Komunikimi me OJF-të merr një rëndësi të veçantë duke përfshirë për herë të parë një parashikim ligjor që i jep vlerë zyrtare këtij komunikimi.

Një aspekt interesant lidhet me vetë aksesin në informacion që disponon Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Edhe ky është një autoritet publik dhe është subjekt i ligjit. Ndonëse duket paradoksale, ndaj vendimeve të Komisionerit duhet të paraqitet ankim te vetë ky organ, pasi dhënia e informacionit bëhet nga koordinatori për të drejtën e informimit pranë këtij autoriteti, ndërsa ankim shqyrtohet nga Komisioneri.

#### **4. Sanksionet administrative (nenet 18, 21)**

Ligjvënësi është treguar mjaft i ashpër ndaj përgjegjësve për shkeljet e këtij ligji. Kështu, një pjesë e mirë e shkeljeve dënohet me gjobë nga 150.000 lekë deri në 300.000 lekë, por ka edhe shkelje më të lehta të cilat dënohen me gjobë nga 25.000 lekë deri në 50.000 lekë. Refuzimi i dhënies së informacionit dhe shkelja e aspekteve të tjerë të rëndësishëm janë përfshirë në kategorinë e shkeljeve që shoqërohen me gjobat më të rënda.

Masa e dënimit, e përcaktuar me gjobë, shlyhet me këste mujore. Komisioneri ka diskrecionin e plotë të vendosë brenda këtyre kufijve të minimumit dhe maksimumit të gjobës, duke marrë në konsideratë shumë faktorë, ndërmjet të cilëve peshën e shkeljes, përsëritjen e shkeljes nga i njëjti person përgjegjës, kërkuesin (kur ai është gazetar, aktivist i shoqërisë civile, aktivist politik, etj.), llojin dhe rëndësinë e informacionit të refuzuar, qartësinë e dispozitës së shkelur, shkallën e fajësisë së tij, etj.

Këstet mujore të pagesës së gjobës ndahen në një masë të tillë që nëpunësit dhe familjes së tij t'i garantohet jetesa, të paktën në nivelin e pagës minimale të caktuar me vendimin e Këshillit të Ministrave.

Për dëmtimin ose shkatërrimin e dokumenteve zyrtare me qëllim shmangien e së drejtës për informim, si dhe për moszbardhjen e dokumenteve zyrtare me qëllim pengimin e ushtrimit të së drejtës për informim, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mund të propozojë marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës. Këto masa mund të

jepen krahas dhënes së gjobave. Gjithashtu, ndonëse ligji nuk e përmend në mënyrë specifike, sipas rastit Komisioneri mund të bëjë edhe kallëzim penal për këto shkelje, në rast se ato përbëjnë vepër penale.

## **5. Ankimi i sanksioneve administrative (neni 22)**

Ndaj vendimeve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënavë Personale, kundërvajtësi, mund të bëjë ankım në gjykatë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit për vënien e sanksionit administrativ. Ankimi bëhet në përputhje me ligjin nr.10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”.

## **6. Arkëtimi i shumave të detyrimeve (neni 23)**

Në rradhë të parë vlen të theksohet se gjobat nuk shërbejnë për të riparuar dëmin e shkaktuar kërkuesve për shkak të refuzimit ose vonesës së dhënes së informacionit. Dëmshpërblimi është aspekt i veçantë sepse synon riparimin e një gjendjeje dhe rikthimin në gjendjen e mëparshme në atë masë që është e mundur. Ndërsa gjoba synon ndëshkimin e kundërvajtësit dhe shuma e arkëtar kalon për llogari të buxhetit të shtetit.

Vendimi i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënavë Personale për vendosjen e gjobës i komunikohet titullarit të autoritetit publik dhe zyrës së finances pranë atij autoriteti. Gjobat ekzekutohen nga zyra e financës së autoritetit publik për të cilin punon kundërvajtësi, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të tyre. Me kalimin e këtij afati, nëse kundërvajtësi nuk e ka ekzekutuar vullnetarisht pagimin e gjobës, vendimi i dhënë shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit me kërkesë të Komisionerit.



PROCEDURAT  
PËR SHQYRTIMIN  
E ANKESAVE

KREU VI

## 1. Procedurat për shqyrtimin e ankesave (neni 24)

Ligji i mëparshëm, tashmë i shfuqizuar, e rregullonte të drejtën e ankimit në mënyrë të përgjithshme, vetëm duke e referuar atë te Kodi i Procedurave Administrative. Sipas ligjit të mëparshëm, ankimi bëhej tek autoriteti epror brenda 30 ditësh dhe ky i fundit merrte vendim brenda 30 ditësh.

Sipas ligjit të ri, ndaj vendimit të refuzimit, apo mosveprimit brenda afateve ligjore të autoritetit publik, si dhe për çdo të drejtë tjetër të parashikuar nga ligji, çdo person, kur çmon se i janë shkelur këto të drejta, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në këtë mënyrë, Komisioneri bëhet i vetmi organ kompetent për shqyrtimin e ankimeve administrative.

Ezaurimi i ankimit administrativ është parakusht për t’iu drejtuar gjykatës. Nëse ankimi ndaj veprimit apo mosveprimit të paligjshëm të autoritetit bëhet drejtpërdrejt në gjykatë, atëherë kjo e fundit, në bazë të ligjit nr. 49/2012 do të shpallë mungesën e juridiksionit, duke e dërguar çështjen për t’u shqyrtuar nga Komisioneri. Por në këtë rast do kenë kaluar afatet e ankimit dhe do të rrëzohet për mospërmbushje të kushteve formale. Për këtë arsyе është shumë e rëndësishme të ezaurohet ankimi administrativ në çdo rast.

Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 diteve pune nga dita kur:

- ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit;
- ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.

Nëse ankimi bëhet pa pritur plotësimin e njërit prej këtyre dy kushteve, atëherë ankimi do të rrëzohet. Për këtë arsyë është e rëndësishme që të pritet përgjigja nga vetë autoriteti publik, deri ditën e fundit të afatit ligjor.

Ankimi bëhet gjithmonë me shkrim, i cili mund të dorëzohet dorazi, apo me anë të postës. Ankimi në rrugë elektronike nuk pranohet.

Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ia kalon atë strukturës që merret me të drejtën e

informimit (kemi para sysht që Komisioneri ka dy detyra, mbrojtjen e të drejtës së informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, dhe për këtë arsy funksionon me dy struktura të ndara), e cila verifikon faktet dhe bazën ligjore të ankesës. Për këtë qëllim, Komisioneri mund t'u kërkojë ankuesit dhe autoritetit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim si dhe të informohet nga çdo person dhe burim tjetër.

Si rregull Komisioneri gjykon mbi bazën e dokumentave dhe nuk i thërret palët në seancë. Por, në raste të veçanta, kur e sheh të nevojshme, Komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve. Në seancë mund të marrin pjesë si dëgjues edhe persona të tjera që nuk janë palë në proces.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita kur është dorëzuar ankimi. Nëse Komisioneri merr vendim në tejkalim të këtij afati, vendimi nuk e humb vlerën e tij. Tejkalimi i afatit do të shërbejë si një indikator në vlerësimin e punës së tij nga Kuvendi, duke marrë sipas rastit edhe masat përkatëse.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale disponon në katër mënyra të ndryshme, duke vendosur:

- a) mospranimin e ankesës (kur nuk ka plotësuar kushtet formale)<sup>18</sup>
- b) pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit publik për të dhënë informacionin e kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme;
- c) rrëzimin e ankesës, pjesërisht ose tërësisht;
- ç) afatin, brenda të cilit autoriteti publik duhet të zbatojë urdhërin.

Mospranimi i ankesës bëhet kur:

- ka kaluar afati i parashikuar në ligj për të paraqitur ankesën (30 ditë pune);
- ankimi nuk paraqitet në formë shkresore;
- nuk tregohet emri dhe adresa e ankuesit;

---

18 Me Vendimet nr. 23, datë 27.03.2015 dhe nr. 34, datë 29.05.2015, Komisioneri për të Drejtën e Informimit ka rrëzuar ankesat e paraqitura jashtë afatit 30 ditor. Mosplotësimi i kushtit formal (afatit në rastin konkret) sjell si pasojë mosshqyrtimin e themelit të ankesës, edhe sikur ankesa në thelb të jetë e drejtë.

Është shumë e rëndësishme që ankesa të paraqitet pas ezaurimit të përgjigjes ose afatit të saj prej autoritetit publik dhe pa kaluar afati prej 30 ditëve pune, në formë shkresore, ku të jenë paraqitur qartë të dhënët e emrit, mbiemrit, adresa e saktë dhe e plotë, si dhe nënshkrimi i personit ankues, si dhe vula (në rastin e personit juridik).

Në qoftë se Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit prej 15 ditësh pune, ankuesit i lind e drejta për t'iu drejtuar gjykatës. Në asnjë rast kërkesë padia në gjykatë nuk duhet paraqitur përpara mbarimit të afatit që Komisioneri ka të drejtë të marrë vendim.

## 2. Avokati i Popullit (*neni 24, pika 7*)

Një parashikim i veçantë është rezervuar në ligj për rolin e Avokatit të Popullit. Përpara hyrjes në fuqi të ligjit të ri, Avokati i Popullit luante rolin e organit kujdestar për të drejtën e informimit, duke investiguar rast pas rasti sipas ankesave të kërkuesve të ndryshëm. Avokati i Popullit nuk kishte rol vendimmarrës për të detyruar autoritetet publike që të jepnin informacion dhe as të vendoste sanksione administrative. Avokati i Popullit mund të nxirre vetëm rekomandime pa fuqi detyruese.

Aktualisht krijimi i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka krijuar një organ të ri vendimmarrës me fuqi ekzekutive, i cili nuk kontraston veprimtarinë e Avokatit të Popullit në thelb. Avokati i Popullit përsëri mund të shqyrtojë ankesa, mund të investigojë raste të veçanta, sidomos rastet kur pretendohet në mënyrë abuzive që informacioni nuk disponohet nga autoritetet. Avokati i Popullit mund të nxjerrë në vazhdim rekomandime për përmirësimin e zbatimit të të drejtës për informim, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira. Avokati i Popullit mund të ofrojë raporte ndihmëse në rastin e shqyrtimit të një ankimi administrativ nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sidomos në ato raste kur kërkuesi nuk është i aftë për të argumentuar vetë shkeljet.

Sidoqoftë, Avokati i Popullit nuk e ndjek më tej ecurinë e çështjes nëse ajo i nënshtronhet shqyrtimin gjyqësor.

Për arsyet e mësipërme, ligji thekson se nuk cenon kompetencat e Avokatit të Popullit lidhur me mbikëqyrjen dhe zbatimin e të drejtave civile sipas ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”.

### **3. Ankimi në gjykatë (neni 25)**

Kundër vendimeve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mund të ushtrohet ankim në gjykatë. Nëse Komisioneri e ka përmendur të drejtën e ankimit në dispozitivin e vendimit të tij dhe ka specifikuar afatin 45 ditor (sipas ligjit nr. 49/2012) atëherë afati i paraqitjes së padisë në gjykatë është 45 ditë (kalendarike). Nëse Komisioneri nuk e specifikon të drejtën e ankimit në vendimin e tij, atëherë afati i paraqitjes së padisë në gjykatë është 1 vit. Ankim në gjykatë mund të bëjnë secila nga palët e përfshira në proces, kërkuesi ose autoriteti publik. Gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes do të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë.

Një aspekt interesant dhe me pasoja praktike është fakti që Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka selinë e tij zyrtare në Tiranë. Kjo bën që sipas ligjit nr. 49/2012 kompetente për shqyrtimin e të gjitha ankesave do të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Ky parashikim ligjor mund të krijojë probleme në praktikë për kërkuesit që jetojnë në qytete apo zona të tjera rurale. Ligji i ri nuk e ka qartësuar këtë aspekt.

Megjithatë, për ndërtimin e një ndërgjyqësie sa më të rregullt, tek palët e paditura në kërkësë padi duhet të shtohet edhe autoriteti publik që ka refuzuar informacionin. Pra padia do të ngrihet ndaj të dyve, edhe ndaj autoritetit publik, edhe ndaj Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Kjo është një domosdoshmëri, pasi nëse gjykata do të urdhërojë autoritetin publik që të japë informacionin e refuzuar, ky autoritet duhet të jetë i paditur, në të kundërt gjykata nuk mund ta urdhërojë dot, ose në të kundërt, po e urdhëroi gjykata autoritetin publik pa e thirrur si palë në gjykim, kjo mangësi do të cilësohet si shkelje dhe si shkak për t'u prishur vendimi nga gjykatat më të larta.

#### 4. Shpërblimi i demit (*neni 26*)

Njëloj si ligji i mëparshëm, edhe ligji i ri parashikon se çdo person, që ka pësuar një dëm për shkak të shkeljes së dispozitave të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar në përputhje me Kodi Civil të Republikës së Shqipërisë. Në lidhje me këtë aspekt mund të japim disa konsiderata:

- Së pari, shpërblimi i dëmit nuk mund të kërcohët në ankimin administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Shpërblimi i dëmit mund të kërcohët drejtpërdrejt në gjykatë, por vetëm pasi të jetë ezauruar shqyrimi i çëshjes kryesore që ka të bëjë me refuzimin e të drejtës së informimit. Kështu, në rast se kërkuesi do t'i drejtohet gjykatës për të kërkuar aksesin në të drejtën e informimit, ai mund të shtojë në objektin e tij të padisë edhe shpërblimin e dëmit.
- Së dyti, shpërblimi i dëmit pasuror është shumë i vështirë për t'u llogaritur dhe përgjithësisht duhet pajtuar një ekspert, i cili caktohet nga gjykata që në veprimet përgatitore, duke ngarkuar me kost paraprake nisjen e procesit gjyqësor. Kostot e ekspertimit nuk rimbursohen në rast se padia nuk pranohet.
- Së treti, shërbimi i dëmit jopasuror është më i lehtë, pasi mjafton që të deklarohet nga kërkuesi dhe të përcaktohet një shumë e arsyeshme, të cilën gjykata do ta vlerësojë në diskrecionin e saj të plotë. Për dëmin jopasuror nuk është i domosdoshëm pajtimi i një eksperti, me përjashtim të rasteve të rralla, kur nevojitet pajtimi i një eksperti psikolog.
- Së katërti, baza ligjore nuk është vetëm Kodi Civil (siç shprehet ligji i ri), por në mënyrë të veçantë edhe ligji nr. 8510 dt. datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”
- Së pesti, shpërblimi i dëmit nuk kërcohët vetëm në rastin e refuzimit të informacionit, por edhe për shkelje të tjera, të cilat nuk janë objekti i shqyrimit nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbi bazën e një ankesë.

## KONSIDERATA TË FUNDIT

Në përgjithësi vihet re se ligji i ri nuk përbën vetëm një përmirësim të thjeshtë të kuadrit ligjor për të drejtën e informimit, por një reformë rrënjosore që thérret në veprim shumë koncepte të reja.

Gjatë momenteve të para, deri në trajnimin e plotë të koordinatorëve, dhe të stafit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe deri në momentin e implementimit të programeve të transparencës, zbatimi i ligjit do të shoqérohet me një moment tranzicioni. Gjatë kësaj faze 6 mujore (në praktikë mund të zgjasë më shumë) pritshmëria duhet të jetë më e ulët dhe mirëkuptimi ndaj autoriteteve më i madh.

Është veçanërisht një domosdoshmëri që shoqëria civile dhe gazetarët të ushtrojnë sa më shumë të drejtat e fituara nga ky ligj i ri, në mënyrë që të evidentohen të gjitha problemet që pa një test të mirëfilltë praktik nuk mund të merren me mend në mënyrë teorike. Në mënyrë teorike presupozohet që vullneti i autoriteteve dhe aftësia e tyre për zbatimin e ligjit të jenë në nivele të kënaqshëm. Prezupozohet gjithashtu edhe funksionimi i mirë i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Por praktika do të jetë testi më i mirë dhe në gjashtë muajt e parë ky autoritet ka demonstruar cilësi të mirë të vendimeve dhe seriozitet në trajtimin e ankesave.

Ligji ka krijuar hapësira për të siguruar një transparencë që deri më parë as nuk ishte imagjinuar. Është në interesin e të gjithë shoqërisë që ky ligj të kthehet në shembullin më të mirë të armës së dhuruar publikut për të luftuar pikërisht fabrikuesin e vet, me qëllim pastrimin e tij nga çdo qelizë e korruptuar.

Qeveria punon më mirë kur ajo është transparente.



Komentar mbi ligjin nr. 119/2014  
“Për të drejtën e informimit”. Material  
informues për gazetarët dhe aktivistët e  
shoqërisë civile.

Qendra “Res Publica”, maj 2015  
68 f; format A5



[www.respublica.org.al](http://www.respublica.org.al)

---